

Raport permbledhes mbi konsultimet me publikun mbi Programin buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe buxhetin e vitit 2024.

Titulli i Projekt-aktit : “Programi buxhetor afatmesem 2024-2026 dhe Buxheti 2024”

Grupet që u konsultuan: Banorët e Rajoneve 1,2,3,4,5, dhe te gjitha njesive administrative, grupe interesi dhe shoqata te ndryshme, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime : 477 persona, prej te cileve 97 gra dhe vajza

Numri i personave që dhanë rekomandime: 229

Keshilli i ka kushtuar vemendje te vecante degjesave publike per projektaktet per te cilat kerkohet nga ligji. Jane zhvilluar degjesa publike per 3 projektakte, 2 rregulloret dhe PBA 2024-2024 dhe Buxheti 2024. Në degjesat për buxhetin moren pjese gjithsejt 477 qytetare, 380 meshkuj dhe 97 femra, qytetar, biznese, grupe interesi, anëtar këshilli konkretisht, u dhanë 626 rekomandime në dëgjesa publike. Kryesisht kërkesat e qytetareve jane mbi:

- Përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, kopshteve cerdheve,
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore,
- Përmirësimin e shërbimeve publike ujësjelles kanalizime, menaxhimi i mbetjeve, zgjerimi i rrjetit të ndricimit publik
- Pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditese
- Shtimi i hapësirave recreative per te rinjte
- Përmirësimi i transportit urban dhe lidhja e tij me rrjetin rural
- Shërbimet ne favor te bizneseve qe punojne per turizmin

Te gjitha informacionet per konsultimet e publikun jane publikuara ne regjistrin online per konsultimet me publikun ne faqen web te keshillit bashkiak.

Ne vijim jane proces verbalet per secilen prej degjesave te mbajtura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : Njësia administrative Ana Malit.

Data : 10.10.2023

Ora : 15:00

Vendi: Shkolla “Idriz Hoxha”

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 31, nga të cilat 10 gra, dhe 21 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Skender Taipi**, i cili shprehet se ato kanë problem në lidhje me:

1. Shërbimet në shkolla, lyerja, rregullime të vogla si ndërrim bravash, xhamash etj.
2. Punën online, në shkolla ka nevojë për kompjutera sepse çdo e dhënë duhet të hidhet në sistem. Në shkolla e zonës asnjë kompjuter nuk funksionon dhe kemi nevojë emergjente për to. Nuk kerkojmë salla informatike por kompjuterat për mesuesit janë të domosdoshëm sepse nuk ka më rregjistra, minimalisht një kompjuter duhet për çdo shkollë, po ashtu ka nevojë dhe për printera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Kopshti Oblikë nuk pastrohet nga sanitare por nga vetë edukatorët. Kopshti aty është i shkëputur nga shkolla dhe ka 26 fëmijë present, prandaj duhet gjetur një zgjidhje.
4. Punonjësit e shërbimeve nuk realizojnë pastrimin e oborreve, prandaj duhet të ketë një mënyrë për organizmin e njësisë administrative për pastrimet e oborreve të shkollave. Detyrat janë të përcaktuara, duhet vetëm koordinimin mes stafit dhe njësisë administrative.

Kryetari i Bashkisë Z.Benet Beci shprehet se do pajisen të gjitha shkollat funksionale me kompjutera dhe printera.

Z. Selim Alija, administrator i njësisë administrative Ana Malit, i uron mirëseardhjen Kryetarit dhe e përgëzon për punën që po bën.

Fahrie Behari, banore fshati Xhakaj shpreh shqetësimet e saj:

1. Ndërtimin e rrugës në lagjen Xhakaj, pasi aty ka edhe një rrez invalidë.
2. Nevojën për kosha mbeturinash.
3. Mungesën e ndricimit elektrik.
4. Mungesën e ujit sepse edhe ujësjellësi që po ndërtohet nuk kalon në lagjen Xhakaj.

Kryetari Z.Beci shprehet se kryhen verifikime për ujësjellësin nëse kalon ose jo në lagjen Xhakaj përmes administratorit.

Znj. Rezarta Pode, Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak shprehet se prioritet duhet të jenë:

1. Ngrohja në shkolla dhe fikset e zjarrit.
2. Pranë ambjentëve të shkollës ndodhet dhe një muze, ku ka një shtypshkronjë që daton në 1483 dhe shumë artefakte të tjera të mbledhura në vite të cilat duhet të jenë të aksesueshme për publikun. Duhet të merren në ruajtje dhe të kemi mundësi t'i promovojmë.

Z.Sulejman Lakti, banor fshati Muriqan shprehet se ka filluar zbatimin e investimeve me vite por rrugët nuk janë përfunduar. Janë në total 6 km rrugë të papërfunduara si:

1. Varrezat e Shtufit
2. Lagja Goricë
3. Lagja Alimetaj

Shqetësim tjetër mbeten legalizimet, banorët paguajnë bëjnë kërkesa dhe s'marrin përgjigje

Kryetari Z.Beci përgjigjet se Bashkia do vazhdojë t'i drejtohet Hipotekës për të përshpejtuar procedurat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Sulejman Lakti sugjeron se duke qënë se jemi zonë bujqesore dhe prodhojmë produkte, do ishte me interes që të krijohej:

1. Një qendër grumbullimi apo magazinimi për produktet tona sepse është e pamundur të dalim çdo ditë për të tregtuar në qytet.
2. Tjetër shqetësim është tensioni i lartë për të gjithë zonën sepse është shumë afër me tokën. Po ashtu edhe rrjeti është i dobët dhe dëmtohet shpesh.
3. Shërbimi urban është një tjetër problem, që ka nevojë për një zgjidhje, kemi vetëm fugonët e palicencuar dhe duhet të ketë një rrjet urban publik.

Kryetari, Z.Beci shprehet se po punohet për pjesën e riorganizmit të sistemit të transportit.

Z. Grigor Pema, krytar i fshatit OBOT merr fjalën dhe shpreh shqetësimet e banorëve të zonës:

1. Një pjesë e rrugës së fshatit është shumë e ulët dhe kemi nevojë, që të ndërhyhet pasi shumë shpesh bllokohet.
2. Rruga e fshatit tek kthesa e Bunës, krahu i rrugës mbetet i përmbytur sepse ka disnivel mes dy krahëve të rrugës, ka nevojë të ndërtohen dy ura për të bërë të mundur kalimin e ujit.
3. Mbrojtja nga lumi Drin është shumë e rëndësishme për zonën e Obotit. Kemi argjinaturë të dëmtuar afër kishës e në vazhdim.
4. Në kufi të obotit me Muriqanin uji futet ne oborret e shtëpive sepse nuk ka mbrojtje.
5. Shtrimi i rrugës së kishës në Obot rreth 500 metra rrugë.
6. Ka nevojë për ndërhyrje në ndriçimin e fshatit.
7. Fshati Obot ka nevojë për ujë të pijshëm. Banorët kanë bërë shpime por duhet gjetur një zgjidhje për gjithë fshatin, ndoshta me një shpim kryesor që t'i shërbejë të gjithë zonës.
8. Duhet të pastrohen dy kanale të emergjencave, që qojnë në urën e Salicës .

Kryetari, Z.Beci përgjigjet se përsa i përket urave, jemi në proces të ndërtimit të tyre

Alban Sekja – Kanali në fjalë shërben si kanal emergjence dhe duhet të ndërhyhet direkt, dhe nuk ka nevojë për buxhet.

Muhamet Malli, banor fshati Alimetaj merr fjalën dhe shprehet:

1. Ne jemi një zonë e banuar pas viteve 90 me rreth 70 – 80 shtëpi. Pproblemi jone ka qenë gjithmonë rruga, mungojnë vetëm 500 metra rrugë për tu lidhur me qendrën dhe 500 metra të tjera për t'u lidhur me lagjen.
2. Po ashtu kemi nevojë për ujë të pijshëm, sepse jemi me puse dhe shpime por ka ujë të pijshëm.
3. Kemi përmbytje nga përroi, i cili ka nevojë për pastrim dhe mendoj që duhet filluar nga Buna sepse pastron të gjithë zonën Velinaj – Oblikë. Pjesë kjo rreth 3 km.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Kryetari, Z.Beci shprehet se ne shpresojmë që kontributi juaj në vite dhe mbështetja e qeverisë së bashku me angazhimin tonë të bëjme punë të mira.

Rezarta Pode, thotë se ka nevojë për ndërhyrje në:

1. Ndricimin publik duke qenë se është rrugë nacionale dhe turistike.
2. Zona e pallateve ka nevojë për ndërhyrje emergjente në fasada.
3. Pastrimni e kanaleve kulluese dhe ujitëse.
4. Pastrimin dhe sistemimin i përroit.

Xhevdet Kurti, banor fshati Alimetaj kërkon që:

1. Legalizimet të shikohen si proces nga ana e Bashkisë pasi ka vonesa.
2. Duhet parë telat e tensionit të lartë dhe sistemimi i rrjetit në zonë.
3. Ka probleme me ujin e pijshëm.
4. Ka nevojë për ndërhyrje në rrugën Alimetaj.

Meqail Shpjetra, banor fshati Velinaj shprehet se:

1. Ruga, deri tek fillimi i fshatit është përfunduar por duhet të përfundohen edhe 500 metra të mbetura.
2. Rrjeti i ujësjellësit ka të meta dhe është tepër i amortizuar
3. Kanalet kulluese kanë nevojë të pastrohen sepse ka vite që nuk është vënë dorë.

Kryetari, Z.Beci shprehet se duhet bërë një rrjet të ri në këtë zonë.

Mri Shkami, banor fshati Oblikë merr fjalën dhe shpreh problematikat tek pallatet e zonës:

1. Mungesën e ujit të pijshëm tek pallatet në Oblikë.
2. Mungojnë kanalizimet e KUB dhe KUZ.
3. Fasadat e pallateve kanë nevojë për ndërhyrje pasi janë shumë të vjetra dhe nuk t'i bëjmë me fonde tona.
4. Punësimi i banorëve Oblike është shumë i ulët.
5. Duhet shtuar kontenierët e mbeturinave sepse jemi shumë banorë.

Kryetari, Z.Beci përgjigjet se nesër do vendosen koshat pranë zonës së pallateve.

Z. Osman Vataksi, fermer dhe kryeplak merr fjalën dhe shprehet:

1. Kemi problem me ujin dhe ai ka një propozim: tensioni i lartë kalon midis fushave dhe a është e mundur të vendosen transformator në këtë zonë për të bërë vaditjen e kësaj zone.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

2. Disponoj 300 kv grurë dhe e shesim shumë lirë, kemi nevojë për një magazinë ose pikë grumbullimi që ta mbajmë produktin dhe mos ta shesim me cmim të lira.
3. Zjarret në pyje dhe në Tarabosh vazhdojnë të mbeten shqetësim, duhet të vendoset një vëzhgues për zjarret gjate dy muajve më të nxëhtë.

Kryetari , përgjigjet në lidhje me pikën e parë duke thënë se nuk është e mundur që të bëhet ndërhyrja e kërkuar. Kurse përsa i përket magazinave sugjerimi është me shume vlere sepse duam që të nxisim prodhimin dhe ekonominë lokale. Dhe për zjarret kemi në zbatim një projekt për vendosje të sensorëve në zonat më me rrezik zjarri.

Z.Qamil Leka, banor shprehet se:

1. Magazina duhet të jetë private, dhe nuk duhet medeomos shteti t'i bëjë ato.
2. Jemi zonë problematike nga përmbytjet, duhet te mendohet një zgjidhje shteruese për këtë sepse përveç dëmeve, bën edhe gërryerje të tokave duke na marrë edhe toka bujqësore.
3. Kemi probleme edhe me ujësjellësin Muriqan.
4. Kemi dy objekte rezervuare uji në Muriqan që nuk perdoren dhe tani po bëjmë të tretin, ndërkohë që akoma nuk janë vënë në funksion 2 të parët.

Kryetari, pyet nëse kemi vende të njohura se ku mund të hidhen inertet?

Z.Albani Sekja, drejtor dr.Bujqësisë shprehet se ndërhyrja mund të kryhet vetem nga bordi i kullimit.

Fahrije Behri , banore shprehet se prodhimet e zonës Xhakaj janë te gjitha mbi rrugën tonë dhe nuk kemi ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugës dhe shërbimeve publike. Duhet edhe ne të paguajmë taksat dhe tarifat që kemi detyrim.

Kryetari Z.Beci shprehet se kemi pasur deri tani mungesë besimi të ndërsjelltë dhe kjo do të krijohet përmes punëve të bëra dhe komuniteti atëherë do të ketë mundësi të kontribuojë dhe të jetë më i përgjegjshëm. Janë të dy palët që duhet të ndërveprojnë.

Tjetër shqetësim i banorëve është mungesa e ujit në tregun e shumicës në Dobraq dhe qentë e rrugës.

Kryetari përgjigjet se ndërmarrjen sapo e kemi marrë në dorëzim . Ka pasur probleme në menaxhim ndër vite dhe ne tani do përpiqemi ta vendosim në funksion sa më parë. Kemi krijuar edhe ndërmarrjen e tregjeve dhe së shpejti do të përpiqemi të gjejmë zgjidhjet e munguara.

Znj.Rezarta Pode sugjeron zhvillimin e aktiviteteve kulturore në këtë zonë. P.sh : Panairi i shegës duhet të jetë i përvitshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Problematika të tjera të banorëve lidhur me bujqësinë e zonës janë edhe:

1. Dëmtimet nga përmbytja edhe emigracioni. Zona nuk mund të mbillet me shumë kultura. Cfarë mund të bëjë Bashkia rreth kësaj çështjeje kur dihet që gjithë fshati të ardhurat kryesre i ka nga bujqësia.
2. Farmacitë bujqësore, duhen kontrolluar sepse shpesh herë fara e mistrit del e keqe dhe askush nuk mban përgjegjësi.
3. Rrugët dytësore në funksion të bujqësisë duhen riparë sepse bllokohen rrugët e kalimeve.
4. Infrastruktura rrugore në lagjen Goricë mungon dhe shpesh herë është ndërhyrë nga vetë banorët.
5. Kërkohej eliminimi i taksës për tokën bujqësore për zonën e Anës së Malit.

Kryetari Z.Beci shprehet se nëse na lejon ligji propozimi juaj do merret parasysh sepse është e drejtë duke qënë se ka përmbytje.

Kryetari i bashkisë falenderon pjesëmarrësit për diskutimet dhe sugjerimet e tyre duke thënë se çdo gjë është mbajtur shënim dhe do punohet fort për përmbushjen e kërkesave të tyre. Ai shton se shpejti do të kemi mundësi të rishihemi dhe të krijojmë marrdhënie mirbesimi.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli** deklaroi mbledhjen të mbyllur

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Bërdicë

Data : 16.10.2023

Ora : 15:00

Vendi: Shkolla”Agim Tafili”

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 52, nga të cilat 5 gra, dhe 47 burra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezencë).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Xhavit Pllumbi** dhe shprehet se komuniteti i zonës ka plot probleme dhe shqetësime prandaj kerkojmë vëmendje.

Vijon **Z.Osman Nasufi**, banor fshati Bërdicë e sipërme I cili shprehet konkretisht:

1. Rruga e varrezave është krejtësisht e pashtuar
2. 13 shtëpi nuk kanë rrugë në këtë zonë dhe mungon edhe ndriçimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Mungojnë kanalet kulluese në zonën e Vinjarit (Bërdicë e sipërme)

Tjetër banor i fshatit Bërdicë e sipërme shton se:

1. Problem mbet uji edhe pse jemi pagues të rregullt.
2. Nuk kemi kosha mbeturinash.
3. Mungon ndriçimi në rrugë.
4. Për 100 metra asfalt nuk është përfunduar rruga.

Z. Qamil Dalipi banor fshati Bërdicë e sipërme thotë se:

1. Ujë mbushim me bidona dhe nuk është aspak normale në kohën që jetojmë.
2. Tek rruga nacionale tek harku i Bërdicës mbetet shumë problem kalimi i këmbësorëve dhe paraqet shumë rrezikshmëri.

Kryetari Z.Beci sqaron se aty ka nevojë për sinjalistikë që rregullon kryqëzimin. Do shihet zgjidhja për këtë.

Z. Dalipi shton se ka nevojë për ndërhyrje edhe tek:

1. Rruga tek lagjja e Dajçasorëve 150 metra rrugë dhe ka rreth 30 – 40 shtëpi.
2. Rruga e Mllojseve, po ashtu janë 100 – 200 metra rrugë.
3. Edhe rruga tek komuna bllokohet në rashte rreshjesh sepse nuk ka kullim të ujrave të bardha.

Z.Jak Kroni, banor fshati Bërdicë e sipërme, shprehet se për to problem për shtëpitë është prroni i zonës që shkarkon në Dri. Edhe lagjja Gjomarkaj ka të njëjtin problem. Ka shumë sediment që vjen nga mali dhe prroni bllokohet shume shpejt prandaj duhet pastrim por edhe për të bërë argjinaturë mbrojtëse. Po ashtu ujësjellësi sërist është i papërfunduar.

Banore, fshati Beltojë shprehet se ka plot 33 vite që kjo zonë nuk marrë investime.

1. S'kemi rezervuar.
2. Mungojnë rrugët në fshat.
3. Të rehabilitohen kanalet kulluese.
4. Mungon edhe ndriçimi.

Banor, fshati Trush thotë se:

1. Duhet ndërhyrë në rrugën që lidh fshatin Gjorretej me Velipojën.
2. Tek lidhja e Trushit me rrugën e Dajçit ka një kanal i cili është i bllokuar.
3. Edhe varrezat e zonës së Trushit përmythen nga kanalet e bllokuara.
4. Duhet bërë verifikime të kanaleve në zonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Ndoc Toma, banor fshati Beltojë përsërit se:

1. E gjithë zona e Beltojes nuk ka rrugë.
2. Gjithashtu kanalet kulluese janë shumë problem.

Z.Aleksander Pashuku shprehet se për prronin e fshatit Beltojë është bërë edhe një plan nga zyra e urbanistikës por prroni ka prurje të mëdha dhe me mundësitë e bashkisë ka qenë e vështirë për t'u realizuar.

Z.Zef Dani, banor Bërdicë e madhe thotë se :

1. Banon në qendër të Bërdicës dhe nuk ka ndriçim .
2. Bashkia duhet të sistemojë fasadat e pallatit në qendër të Bërdicës.
3. Fusha e futbollit që është pronësi e bashkisë ka kanale të bllokuara dhe duhet ndërhyrë.
4. Edhe për tokat e marra me 7501 akoma janë marrë edhe pse nuk kanë mbivendosje.

Z.Lin Pici, banor Bërdicë e madhe shton se në shkollën e mesme në qendër të Bërdicës ka oborr të pa mirembajtur.Po ashtu:

1. Duhet te ketë edhe një hapësirë sportive.
2. Të kete gjithashtu hapësirë rekreative për banorët.
3. Fusha e futbollit të vendoset në funksion.
4. Kanalet vaditëse bllokohen nga shkarkimet e ujërave të zeza dhe hedhja e mbeturinave.
Kanë nevojë për pastrim.

Kryetari Z.Beci sqaron se disa probleme kanë të bëjnë me shërbimet e bashkisë dhe nuk ka nevojë për buxhet por duhet të realizohen nga drejtoritë përkatëse. Kurse përsa I përket problematikave me institucione të tjera do mundohemi të kontaktojmë për t'iu ardhur në ndihmë.

Z.Xhelal Myrtja, banor Bërdicë e mesme shprehet se:

1. Kanali kullues në zonë nuk është pastruar me vite, janë rreth 800 metra.
2. Rruga e lagjes në Bërdicën e mesme nuk ka as ndriçim, asgjë.
3. Rruga nga varrezat deri ne hyrje te fshatit ka nevojë të ndërhyhet.
4. Një pjesë e Bërdiceë së mesme nuk vaditet dhe me një ndërhyrje të vogël mund të pastrohet.

Z. Bujar Ferracaku, drejtues në shkollën Bërdicë e madhe flet për problemet e shkollës që ai drejton:

1. Mungon rrethimi i shkollës.
2. Streha e betonit është e rrezikshme.
3. Xhamat dhe dyert e shkollës janë të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

4. Mirëmbajtja e mjedisit bëhet nga ana e punonjësit të shërbimit të komunës dhe kontributit të nxënësve prandaj mendon që duhet të organizohet nga punonjësit e shërbimit të bashkisë apo njësisë administrative.

Z. Gjergj Patrani banor fshati Trush shprehet se duke qënë Ish punonjës i ujësjellësit është në dijeni të shumë probleme të tij. Trushi është fshat i madh dhe duhen shumë shpenzime. Faleminderon për investimin e rrugës që po behet tek lagjja e Malesorëve por duhen edhe 200 metra të tjera. Gjithashtu ai shton:

1. Trushi nuk ka ujë të pijëshëm.
2. Kemi një kanal vaditës i cili është i bllokuar dhe jashët funksioni nga rruga e fshatit Ashtë deri ëe rrugën e Malsorëve.

Kryetari, Z.Beci sqaron në lidhje me ujësjellësin se është e vështirë të financohet nga Bashkia por e kemi në prioritet dhe do të vijojmë kërkesat tona në qeveri.

Banore ,lagjja Gjomarkaj thotë se:

1. Benti i ujit nga Drini duhet të riverifikohet.
2. Rruga aty është shembur dhe të gjitha ujërat e bardha e të zeza janë në rrugë dhe në oborre .

Z.Agim Rexhepi banor Bërdicë e mesme shprehet se:

1. Rruga e varrezave ka nevojë për ndërhyrje.
2. 25 hektar që janë të bllokuara për në rrugën e Velipojës duhen të rishikohen.
3. Rruga dytësore e vjetër në Bërdicë të madhe është në degradim cdo ditë dhe ka nevojë për pastrim të karregjatës
4. Të vendoset edhe një tabelë që lejon kalimin.

Z.Sulejman Tula, banor fshati Trush thotë se:

1. Për ujësjellësin Trush është shumë i shtrenjtë investimi por kemi një shpim që mund të lidhet me rrjetin e ujit dhe të vendoset një çezme në qendër të fshatit Trush që t'i shërbejnë banorëve.
2. Kanalet brenda fshatit duhen të pastrohen të gjithë dhe banorët duhet të t'i lirojnë nga avullitë.
3. Po ashtu kanë nevojë për pastrim edhe kanalet pranë shkollës së mesme.

Z. Bese Pellumbi, drejtor i shkollës Trush shpreh shqetësimet për shkollën që ai drejton:

1. Mirëmbajtjen e shkollës ne bëjmë me anë të prinderve.
2. Ka nevojë për sistemim të bombulave të zjarrit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Siguria e fëmijëve është shumë me rëndësi pasi ka kryqëzim në hyrje të shkollës.
4. Klasat janë me lagështirë.
5. Është bërë një shpim në shkollë dhe nga analizat e bëra rezulton që uji nuk pihet.
6. Ka nevojë për vendosje bumesh pranë shkollës “Seit Tagani”

Banore e fshatit Trush ka ankesa në lidhje me bizneset e hapura në fshat, të cilët shkaktojnë shumë zhurmë pa orar dhe nuk kontrollohen nga askush

Z.Enver Keçi banor fshati Trush shprehet:

1. Kanali vaditës nga trushi në urën e Dajçit ka nevojë për ndërhyrje.
3. Rrugët brenda Trushit kanë nevojë për sistemime.
4. Rruga pranë xhamisë është gjithashtu në gjendje shumë të keqe. Janë rreth 170 metra.

Znj.Violeta Hoxha, banuese në Bërdicë të mesme thotë se për shkollën “Agim Tafili” kemi 3 kërkesa kryesore :

1. Shkolla nuk ka rrethim dhe kjo është emergjente.
2. Mund të bëhet shembja e shkollës së vjetër, ku mund të bëhet investim për të ndërtuar ambiente për të zhvilluar aktivitete sportive.
3. Ka nevojë restaurim të çatisë pasi sepse klasat e katit të fundit janë të degraduara nga lagështira.

Kryetari Z.Beci përgjigjet se do të bëjmë verifikimet e pronësisë dhe do ndërhyjmë sa më parë për këto kërkesa.

Z.Fatmir Dini, trajner futbollit për moshat e reja shprehet se duhet të rizgjoihen aktivitetet sportive në këtë zonë. Edhe fusha sportive ka nevojë për rrethim.

Z.Qamil Rexha, banor fshati Trush, lagjja Maksutaj falenderon për shtrimin e rrugës por shton se:

1. Varrezat kanë nevojë për pastrim.
2. Rruga e fshatit Maksutaj ka nevojë për pastrim sepse ka 20 vite që nuk pastrohet.
3. Gjithashtu kanali ujitës ka nevojë gjithashtu për pastrim.
4. Kemi nevojë për një urë për kalimtarët sepse lidhen shtëpitë e zonës.
5. Edhe kanali i orizit është i mbushur me mbeturina dhe duhet pastruar.

Z. Bes Xhemali shprehet se zona ka shumë nevoja, në infrastrukturë, në kanalet vaditëse dhe kulluese dhe sidomos në qendren shëndetësore. Edhe rrugët e nisura duhet të përfundohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Aleksander Pashuku shton se paralel me rrugën e Trushit ka edhe rrugë të tjera që kanë nevojë për ndërrhyrje. Ai thotë se 4 segmente rruge të fshatit Bërdicë janë bërë me fondet e Bashkisë Shkodër por ka akoma nevojë për ndërrhyrje p.sh tek:

1. Rreth rrotullimi harkut të Bërdicës .
2. Rruga dytësore në fushën e sportit me një bashkëpunim me federatën mund të bëhet një projekt i përbashkët.
3. Në Bërdicën e madhe ka një pallat që I duhet bërë fasada.
4. Po ashtu të shikohet rrjeti I OSHEE në Bërdicë të mesme dhe në Bërdicë të madhe.
5. Fusha e futbollit ka nevojë të pastrohet.
6. Kanalet kulluese dhe vaditese kanë nevojë po ashtu për vlerësim dhe ndërrhyrje.

Znj.Rezarta Pode , anëtare e Këshillit Bashkiak kërkon të verifikohen nevojat e qendrave shëndetësore.

Znj. Suzane Hyseni shprehet po ashtu se qendra shëndetësore ka nevojë për rikonstrukcion të brendshëm sepse krijon probleme edhe për marrjen e çertifikatës nga DSHP.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Dajç.

Data : 12.10.2023

Ora :13:00

Vendi: Pranë Komunës

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 22, nga të cilët 4 gra, dhe 18 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Paulin Colaj**, banor Mali i Gjymtit i cili shprehet se ka nevojë për ndërhyrje në rrugën ku ai banon pasi ka shumë vështërsi kalimi për 17 familje banuese aty.

Vijon kryetari i fshtit Mushan **Z.Gëzim Metalaj** thotë se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

1. Në rrugën e shkollës është bërë loti I dhe ka mbetur rreth 400 metra rrugë për t'u lidhur me shkollën.
2. Ndricimi mungon në këtë rrugë.
3. Rruga e Gramshit, 500 metra rrugë ka nevojë për investim.
4. Uji i pijshëm mungon në zonën e Mushanit. Nuk ka rrjeti ujësjellësi fare.
5. Uji për vaditje është me rrjedhje të lirë dhe nuk funksionon.

Përgjigjet **Z.Alban Sekja**, drejtor drejtorja e Bujqesisë në Bashkinë Shkodër, i cili thotë se kemi projekte teknike të gatshme për zonën e Mushanit dhe për Suka Dajç, por presim financimin gjatë kësaj periudhe nga Ministria.

Në lidhje me ndriçimin përgjigjet **Z.Altin Salihi**, përgjegjës pranë drejtorisë së Shërbimeve publike në Bashkinë Shkodër, i cili shprehet se nuk ka qënë e parashikuar po do shohim mundësitë realizuese.

Z.Hamdi Mlloja merr fjalën dhe thotë se duhet ndërhyrë në:

- Rrugën e shkollës Mushan pasi është një nga rrugët më të përdorura.
- Qendra shëndetësore ka nevojë për rikonstruksion.
- Qendra sociale ku mungon ndriçimi.
- Po ashtu kanali ujitës në Mushan është mbyllur dhe përbën rrezik përmbajtjeje në rast rreshjesh.
- Argjinaturat në Belaj, duhet të verifikohet situata e argjinaturave sepse janë me rrezik përmbajtjeje.

Z.Sandër Gavoqi banor fshati Darragjat shprehet se problem është benti ku janë hedhur gurë shumë keq dhe jo sipas parametrave. Po ashtu edhe vadija, kanalet vaditëse nuk funksionojnë.

Z. Gëzim Mehmetaj, banor fshati Mushan thotë se:

1. Kullimet e ujit dhe kanalet janë që 33 vite papastruar.
2. Ndricimi vazhdon të jetë problem.
3. Rrugët mungojnë.
4. Kanalet duhen verifikuar nevojat për ndërhyrje.

Përgjigjet **Z.Albani Sekja** dhe thotë se ka filluar ndërhyrja në Mushan dhe jemi në proces pune në kanalet e Mushanit, pritet që këtë vit të fillojmë ndërhyrjen në kanalet e dyta dhe ne urat e kanaleve. Por ajo çka është më e rëndësishmja është fakti se muajin tjetër fillon procesi për verifikimin e pronave ku edhe Bashkia është pjesë e komisionit për dhenien e pronësive.

Z.Mustafa, banor fshati Rrushkull shprehet se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

1. Kemi problem me rrjetin e energjisë elektrike ,në mot të keq nuk kemi as ndriçim publik. Kemi nevojë që të ketë një komunikim me OSHEE për zgjidhjen e kësaj problematike në të gjithë zonën e Dajcit, Pentarit, Shirqit dhe Darragjatit.
2. Rruga dhe kanalet kulluese në Suka Dajç dhe Suka Samrisht kanë nevojë për vlerësim pasi në rrugëna për Pentar, ka një kanal kullues i cili duhet pastruar.
3. Ka edhe ujëra të zeza që kalojnë në këtë zonë dhe krijohet situatë e pakëndshme.

Përgjigjet përsëri **Z.Sekja** dhe sqaron se janë rreth 1.2 km kanal dhe është e nevojshme të kemi një ndërhyrje në këtë zonë sepse ka edhe ujëra të zeza që shkarkohen në këtë kanal.

4. Rrugët e fshatit Rrushkull dhe Samrisht duhen të verifikohen.
5. Tjetër rrugë në Kodër Belaj, Rrushkull ku janë **30 – 40 shtëpi** ka në kanal që ka nevojë për ndërhyrje.
6. Mungon gjithashtu rruga nga xhamia e re në Rrushkull.

Z.Kol Mazija, banor fshati Suka Dajç shprehet po ashtu se:

1. Rruga që lidh me varrezat Suka Dajç rreth 430 metra rrugë ka nevojë për investim.
2. Pastrimi nuk kryhet si duhet. Nuk ka kosha dhe frekuenca është e rradhë.
3. Kemi problem me rrjetin e energjisë elektrike.
4. Mungon infrastruktura në qendrën shëndetësore.
5. Ndriçimi në fshat lë shumë për të dëshiruar.

Përgjigjet Zv/kryetari i bashkisë **Z.Onid Bejleri**, i cili thotë se përsa i përket rrugëve do të kemi një mundësi nga FSHZH që të bëjmë disa investime rrugësh brenda fshatrave dhe të gjitha prioriteteteve të zonës.

Znj.Eliona Shkrela, anëtare e Këshillit bashkiak shprehet se duhet vlerësuar situata në rrugën Mali i Gjymtit, edhe mbeturinat dhe frekuenca. Po ashtu shtyllat e tensionit nga OSHEE.

Doktori i zonës **Z.Besnik** merr fjalën dhe shprehet se në zonën Suka Dajç kemi një infermier që ofron shërbime në zonë por kemi infrastrukturë në qendren shëndetësore, duhet bërë një godinë e re pasi është në gjendje të degraduar. Jemi në komunikime me një shoqatë për të bërë të mundur ndërtimin e saj por duhet të shihet mundësia e një toke publike për këtë investim. Po ashtu edhe fshatit Darragjat i mungon qendra shendetsore të gjithë banorët vijnë në Shirq për të marrë shërbim.

Kryetari i këshillit **Z.Luli** shprehet se do kryhet verifikimi nga ana e bashkisë për sa i përket pronësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Tom Pjetrani, banor fshati Samrisht shprehet se është punuar në vite por rrjeti energjisë elektrike mbetet shumë problematik. Edhe rruga është e papërfunduar për Samrisht. Ka nevojë edhe për pastrim të kanaleve dhe të karregjatës.

Znj.Albina, drejtoreshë e shkollave Dajç, Pentar, Shirq shpreh problematikat e shkollës që ajo drejton:

1. Shkolla “L.Ograja” ka nevojë për investime pasi shërben si qendër komunitare, me hapsirë publike dhe mund të ndërtohen edhe ambjente sportive të cilat mund të përdoren edhe nga komuniteti.
1. Shkolla e mesme, kati i parë ka një pjesë jashtë funksioni dhe me një investim të vogël mund të kthehet në ambient sportiv i brëndshëm.
2. Shkolla e Shirqit ka problem emergjent ndarjen e shkollës nga qendra shëndetësore dhe qendra sociale.
3. Kërkojmë që të kemi stola në oborret e shkollav, të cilat duhet të mirëmbahen.
4. Në Shirq, koshat e plehrave nuk duhet të jenë në të njëjtat ambjente të shkollës dhe të qendrës shëndetësore.
5. Në Shirq kemi numër të madh fëmijësh në kopshte dhe duhet të hapet edhe një klasë dhe kërkohet shtim punonjësesh.
6. Tjetër problem mbetet edhe rregjistrimi i pronësisë së shkollave.

Doktori i zonës shton se mbetjet spitalore, firma duhet ti evadojë një herë në 40 ditë, gjë e cila nuk respektohet dhe kjo situatë çon në kërkesën për ndarje të koshave me ato të shkollës.

Z.Elez Doci, banor fshati Shirq shprehet se rruga e kishës , rruga palajve dhe rruga e mirukve vazhdojnë të jenë problematike.

Z.Kanto Lucaj, kryetar fshatit Mali i Gjymtit shprehet se:

1. Ka nevojë për ndërhyrje tek rruga e Malit të Gjymtit.
2. Duhet të bëhet pastrim i karregjiatës në rrugët ekzistuese.
3. Rrjeti I energjisë është problem i vazhdueshëm.
4. Duhet të shihet mundësia e një linje urbane nga Dajci në Shkodër.
5. Të krijohen hapësira publike dhe ambjente rekreative për banorët. Mundësisht të bëhet një park në kodrat e Tepes.

Z.Aleksandër Pashuku shprehet gjithashtu se pastrimi në zonën e Dajçit duhet të jetë edhe angazhim të banorëve sidomos për kanalet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Tom Pjetrani shprehet se shpesh herë vetë banorët bëhen pengesë për pastrin e këtyre kanaleve prandaj Bashkia duhet të ngrejë një grup pune për të verifikuar nevojën për ndërhyrje dhe të të zbatohet ligji.

Z.Oltion Luli shprehet se është mbajtur shënim çdo ankesë dhe sugjerim nga administrate. Duke falenderuar edhe njëherë për rëndësinë e këtij takimi dhe çdo problematike të ngritur për zonën deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Postribë.

Data : 16.10.2023

Ora : 13:00

Vendi: Pranë Komunës

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 27, nga të cilët 4 gra, dhe 23 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z.Muharrem, fshati Vilez merr fjalën dhe shpreh shqetësimet e tij:

1. Në lidhje me arsimin , kemi një shkollë 9 vjecare në të cilën kemi ndërhyrë me shpenzimet tona. Kemi investuar dhe ka 7 vite që nuk as drita, as ujë dhe as tualete.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Kemi nevojë për mbeshtetje nga Bashkia sepse ka nevojë lyerje dhe shërbime. Për më tepër shkolla nuk është e legalizuar, nuk ka dokumente pronësie.

2. Rruga Vilez ka nevojë të ndërhyhet me një fadromë për mirëmbajtje të paktën dy herë në vit sepse lidhet me liqenin e Mazrekun, Drishtin dhe Rragamin.

Z. Bledar Brahimataj sqaron se jemi në dijeni të situatës, por duke qënë se shkolla Vilez nuk ka certifikatë pronësie është e vështirë të bëhet lidhja e kontratave si për dritat ashtu edhe për ujin.

Kryetari këshillit kërkon të dijë nëse është bërë ndonjë kërkesë nga ana e Bashkisë për pajisje me certifikatë pronësie dhe po ashtu ai shprehet se duhet të verifikohet situata nga drejtoria e arsimit sa i përket pajisjes me dokumentacion dhe mundësisë për ndërhyrje në përmirësim të shërbimeve.

Banore, fshati Domen merr fjalën dhe thotë se për këtë duhet të pyeten drejtuesit e shkollës sepse ato i njohin më së mirë problemet e shkollave. Ajo shton se:

1. Postriba ka rreth 11000 banorë dhe ka shumë problematika. Ndërhyrjet në rrugë kanë qenë të pakta, në Domen na është premtuar rruga e brendshme e fshatit. Njihet si ballkoni i Shkodrës dhe është e nevojshme që të investohet për këtë rrugë.
2. Edhe rrjeti i energjisë elektrike është shumë problem dhe me rrezikshmëri.
3. Në Domen është premtuar 2 km rrugë si emergjente dhe duhet të realizohet. Edhe rruga ekzistuese nuk ka as barrier, as kanalizime.
4. Është edhe një pjesë rruge Baks – Mazrek ka nevojë për ndërhyrje në prerjen e bimësisë.
5. Kemi nevojë për ndërhyrje edhe rrjetin e furnizimit me ujë. Na është premtuar vendosja e një tubi, i cili duhet ndërruar në mënyrë që furnizohemi me ujë.

Znj. Edlira Alija, drejtoreshë shkolla “Adem Haxhija” thotë se ka marrë pjesë në të gjitha dëgjesat e mërpëshme për të vlerësuar edhe bashkëpunimit e mirë që kemi pasur me bashkinë. Është realizuar sinjalistika rrugore dhe është bërë ndërhyrje në tualetet e shkollës, kemi marrë edhe bazë materiale por nuk është e mjaftueshme. Sa i përket komunikimit me dr. e Arsimit në Bashki dhe na janë përgjigjur por ka akoma probleme:

1. Kemi nevojë për baze materiale (banka, karrige etj)
2. Kopshti i fëmijëve në shkollë krijon probleme pasi kanë të njëjtat tualete dhe të njëjtat ambiente dhe kjo nuk është normale.
3. Nuk kemi hapësira për takime me prind nuk kemi klasë për psikologun etj.
4. Shkolla ka hapësirë dhe oborr të mjaftueshëm dhe mund të ndertohet një kopsht për fëmijët, shkeputur nga shkolla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

5. Postriba është zonë sportdashëse dhe akoma nuk kemi një hapësirë sportive, 22 klasa me 66 ore fiskulturë, të cilat nuk mund të realizohen.
6. Rrethimi i shkollës, që është premtuar akoma nuk është përfunduar.
7. Kosha mbeturinash duhet të ketë më shumë.
8. Frekuenca e pastrimit po ashtu është shumë e rradhë.

Edhe shkolla në fshatin Ura e shtrejtë ka nevojë për rrethim, derë oborri etj. Kurse shkolla në fshatin Domen nuk mund të quhet as shkollë. Aty ka 8 nxënës por nuk kanë kushtet minimale. Janë gjithsej 2 klasa dhe 2 mësues.

Kryetari i bashkisë merr fjalën dhe thotë që do bëhet rikonstruksion i 2 -3 ambjenteve në Domen, ndërsa në shkollën Adem Haxhija do behet investim i ri për një godinë kopshti ku do mund të ketë rreth 50 fëmijë.

Znj. Nexhmije Brahimataj, drejtoresha e shkollës Drisht dhe Viles shprehet se në shkollën e saj nuk ka as ujë as investime. Cdo gjë është bërë nga banorët vetë. As në shkollën e Drishtit nuk është vënë dorë, asnjë ndërhyrje, pervec çatisë dhe ka nevoja të jashtëzakonshme mirëmbajtjeje apo rikonstruksioni si dysheme apo mure etj. Në Mes Myselim ka probleme të vogla me ujin.

Kryetari kërkon të dijë nëse ka mundësi të koordinohen dhe të transferohen nxënësit.

Përgjigjet drejtoresha e shkollës duke thënë që shkollat janë shumë larg me njëra tjetrën dhe është i pamundur koordinimi.

Z. Maliq Corri, shkolla Drisht thotë se problemin në shkolla janë të shumta. Janë 8 shkolla gjithsej në zonë. Dhe sipas rradhës së rëndësisë duhet ndërhyrë në Drisht, Kullaj, Vilez, Domen.

Z. Islam Bushi, fshati Kullaj shprehet se shkolla fillore është mbyllur dhe familjarët e fëmijëve të kopshtit kanë investuar vetë për një klasë për të mbajtur hapur një klasë kopshti. Është e nevojshme të hapet përsëri klasa e parë. Po ashtu edhe në qendrën shëndetësore ka një ambient të papërshtatshëm pasi ka afër gropa të ujërave të zeza dhe është jonormale. Qendra e fshatit tonë është e zaptuar nëse ndërhyhet aty mund të bëhet shkolla e qendra shëndetësore së bashku me ambiente rekreative. Po ashtu:

1. Edhe me ujësjellësin kemi shumë probleme dhe duhet ndërhyrje për ujrat e zeza dhe të bardha si dhe rrjetin e kanaleve.
2. Rruga nga qendra e fshatit Domen deri në pyllin e gështenjave është edhe rrugë atraktive dhe duhet rikualifikuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Duhet ndërhyrje edhe në ndricimin e zonës sepse ka disa rrugë dytësore që kanë nevojë për ndriçim.
4. Shumë problem kemi edhe me rrjeti i OSHEE.
5. Bujqësia ka shumë nevojë për kanale vaditëse sepse ka zona e lagje që nuk kanë ku marrin ujë për bujqësinë dhe vaditjen.
6. Ka familje që kanë nevojë për ndihmë ekonomike dhe punësim.
7. Po ashtu në fshatin Gruemirë ka një zonë të lumit Vrakë që nuk ka asnjë mundësi kalimi prandaj është e nevojshme të bëhet një urë lidhese për këto dy fshatra.
8. Duhet të mendohet edhe për mirëmbajtjen e disa kanaleve në zonë.

Z. Hamit Bushaj, banor fshati Postribë shprehet se në Suka Kullaj rruga është e pashtuar rrugë kjo që lidh 30 familje dhe ka nevojë emergjentë për ndërhyrje. Gjithashtu për ujin nevojiten 600 metra tubacione.

Kryetari **Z.Beci** shprehet se do bëhet një listë sipas sektoreve për të gjitha njësitë.

Z.Maliq Çoli shprehet se ujësjellësi në Drisht ka nevojë për rindërtim të rrjetit dhe duhen vendosur matesat. Po ashtu:

1. Ka nevojë për riparim të një ure teli në Drisht ose të shihet mundësia e ndërtimit të një ure të re.
2. Lagjja e re ka nevojë për asfalt dhe ndriçim.
3. Edhe në lidhje me OSHEE ka nevojë për ndërhyrje.

Z.Shkelqim Spahija, banor fshati Boks shprehet se:

1. Në Postribë tokat janë ndarë sipas ligjit 7501 por akoma nuk jemi pajisur me tapi.
2. Nuk mund të ndërtojmë në këto toka dhe nuk kemi mundësi të marrim leje.

Z.Artan Spahija banor, Boks Postribë thotë se uji i pijshëm është i papërdorshëm sepse përzihet me rreshjet dhe bëhet i pakonsumueshëm. Po mundohemi që të gjejmë një zgjidhje duke ndërhyrë dhe duke vendosur filtra.

1. Zona duhet të ketë ambjente rekreative.
2. Rruga që shkon për Boks është akoma e hapur dhe ka nevojë të rikualifikohet.
3. Ndriçimi publik mungon brenda lagjeve.

Fjalën e merr Kryetari, **Z.Beci** i cili thotë se jemi në fillim të zbatimit të projektit për ndërrimin me ndriçim led në qytet dhe me ndriçuesit aktual të qytetit do pajisen njësitë administrative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Po ashtu ne po mbajmë shënim çdo nevojë dhe në bazë të prioritetit do të vendosim se ku dhe sa do të investohet, gjithmonë sipas emergjencës.

Z.Avenir Çelaj, banor fshati Dragoç shprehet se në Dragoç ka shumë nevoja si :

1. Nungon rruga kryesore nga Boski për Kullaj
2. Rrugët e lagjeve të zonës mungojnë të gjitha.
3. Ka një rrugë që na lidh me Hotin e ri, është rrugë që lidh shumë shpejt zonat.
4. Edhe tek zona e pularisë po ashtu mungon rrjeti i ujës-jellës.
5. Shkolla Dragoç ka gjithashtu nevojë për ndërhyrje tek pjesa e oborrit
6. Qendra shëndetësore po ashtu ka nevojë për ndërhyrje sepse nuk as kushtet minimale.

Z.Ragip Shkreli, banor fshati Boks thotë:

1. Kanali nga Ura e Shtrejtë në Boks ka nevojë për mirëmbajtje.
2. Uji për në fshatin e ri është problem pasi janë mbi 300 ha tokë aty dhe duhet ndërhyrë në rrjet.
3. Kanali dytësor do riparim dhe pastrim total.
4. Ujërat e zeza derdhen në kanalin vaditës.
5. Rruga Boks 900 meter ka shumë mbeturina dhe duhen vendosur kosha si dhe pastruar.
6. Duhet të ketë një punëtor për mirëmbajtjen e rrugëve për 12 fshatrat e zonës.
7. Në kodër Boks nga uji ka përmbytje të tokave sa herë ka rreshje, duhet menduar një zgjidhje.

Z.Muhamet Uraj, banor fshati Mes shprehet se rruga nga qendra Mes deri në kanalin e Shtodrit ka që nga 2007 që nuk është vënë dorë. Po ashtu në fshatin Mes nuk ka as ambulancë as qendër shëndetësore edhe pse kemi ambjent për ndërtimin e një të tilla. Duhet të kemi edhe një ambjent rekreativ për banorët e zonës. Gjithashtu ujës-jellësi dhe rrejtja ka nevojë për ndërhyrje.

Kryeplaku i fshatit Myselim shprehet se zona ka shumë problem:

1. Ka nevojë për ndërhyrje në rrugën që lidh fshatin Mes myselim me fshatin Bardhaj rreth 3 km.
2. Ka nevojë për vendosjen e matësave shtëpi për shtëpi.
3. Qendra shëndetësore në Mes ka vetëm një dhomë.
4. Me shkollat duhet të gjendet një zgjidhje përfundimtare, ndoshta duke i bashkuar në një godinë të vetme.
5. Po ashtu kemi nevojë ambjente sportive ose kopshte.
6. Kanalet ujitëse kanë nevojë për pastrime por edhe ndërhyrje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

7. Kanalet vaditëse kanë nevojë për pastrime.

Z.Lulash Lulashi shprehet po ashtu se mulliri që bluan grurin dhe misrin për zonë Postrinë ka nevojë për riparime. Edhe tubat në zonën e kanalit në Prekal kanë nevojë për ndërhyrje. Duhet gjithashtu një urë teli në Prekal rreth 16 metra.

Z.Muho Hasaj gjithashtu shprehet se fshati i ri fshati nuk ka asnjë investim, duhen kazana mbeturinash, nuk kemi as rrugë, as ndriçim kur ka mbi 100 shtëpi në zonë. Nuk funksionon as rrjeti i ujësjellësit.

Z.Beci shprehet se është mbajtur shënim çdo ankesë dhe sugjerim nga administrata e tij. Duke falenderuar edhe njëherë për rëndësinë e këtij takimi dhe çdo problematike të ngritur për zonën deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Rajoni nr.1.

Data : 18.10.2023

Ora : 15:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 80, nga të cilat 20 gra, dhe 60 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr një **banor i lagjes Guerrile, rruga Karvanaj** i cili shprehet se është filluar një ndërhyrje për sa i perket kanalizimeve por është kërkuar gjithashtu që përmes ujësjellësit të bëhet një ndëryhje për kanalizimet e ujrave të zeza, ka nevojë për verifikim.

Z. Brahim Myrtja, banor i lagjes Bahçallek shprehet se ka probleme në lidhje me hipotekën dhe procesin e legalizimit. Sugjerojmë ngritjen e një komisioni që verifikon situatën midis



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Bashkisë dhe Hipotekës për të përfunduar një herë e mirë procesi i dokumentacionit të pronësisë po ashtu ai shton se:

- Duhet gjetur një zgjidhje për trafikun në Bahçallek.
- Pusetat e kanalizimeve të ujërave të zeza kanë nevojë për ndërhyrje. Në zonën e Bahçallekut ka vite që nuk janë pastruar.
- Të verifikohet pastrimi dhe frekuenca.
- Të hapen sa më shumë qendra dhe kënde sportive.

Z. Mhill Rrasa shprehet optimist sepse në një periudhë kaq të shkurtër janë bërë investime dhe ndërhyrje të shumta por shton se:

1. Kemi problematike qentë në qytet dhe duhet gjetur një zgjidhje.
2. Administrata e Bashkisë të jetë e përgjegjshme dhe të funksionojë me rregulla duke marrë përgjegjësi për detyrat e tyre.

Z. Kudret Shatsa, përfaqësues i komunitetit Rom dhe Egjyptian shprehet se kanë qënë gjithmonë bashkëpunues me Bashkinë në vite por nuk kemi pasur të njëjtën mbështetje nga ana e Bashkisë. Kërkojmë që edhe ne të marrim vëmendje në ofrim shërbimesh si p.sh:

- Rruga kryesore që shkon për në Shirokë kalon nga lagjja Iliria dhe duhet të tregohet vëmendje si për pastrimin ashtu edhe për ndriçimin.
- Gjithashtu shtëpitë e komunitetit Rom duhet të rikonstruktohen.
- Bllokimi i rrugëve pranë lagjes iliria krijon probleme për emergjencat e zjarrfikëses dhe ambulancës.
- Kanalizimet e zonës nuk janë pastruar në vite dhe duhet të ndërhyhet.

Banor lagjja Kiras thotë se rruga Selim Çoba rreth 200 – 300 metra (Zooteknik qendër) ka nevojë për asfaltim dhe ndërtim të rrjetit të kanaleve. Po ashtu ka problem sa i përket rrjetit të furnizimit me energji OSHEE në zonën e ish-Zooteknikës, duhet të ketë lidhje me furnizimin e qytetit.

Z. Shqipër Bala, banor Lgj:Ndocej po ashtu thotë se kemi dy rrugica me rreth 40 metra të cilat kanë nevojë të asfaltohen.

Z. Gezim Daija, banor lagjja Zuktha shpreh shqetësimin e tij në lidhje me rezervuar uji që ndodhet mes 4 ndërmarrjesh, e cila është rrezik për zonën dhe duhet prishur.

Z. Valentin Deda, banor pranë Bexhestenit shprehet se është administrator i pallatit të ri pranë Bexhestenit dhe kërkon që të vendoset në funksion ligji për bashkëpronësinë dhe administratorët e zyrtarizuar të pallateve. Ai shton se ka pasur kontakt me administratën e Bashkisë por tek zona



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

e tyre e banimit akoma nuk ka ndërhyrje konkrete për pastërtinë, rregullin dhe sinjalistikën prandaj kërkojmë

1. Vendosjen e kazanëve të mbeturinave spse ka ka akumulim të mbetjeve dhe krijon shumë problem për hixhenën.
2. Sinjalistika të kontrollohet dhe respektohet mes banorëve dhe qytetarëve të tjerë sepse krijon shumë problem. Kemi bllokim të rrugës për tek parkimi etj.
3. Për policinë kemi pakënaqsi dhe duhet të ketë një koordinim mes institucioneve.
4. Motorrët që kalojnë në pedonalen e bixhistenit krijojnë shpesh aksidente.
5. Edhe policia bashkiake po ashtu duhet të jetë më prezente në zonë.

Fjalën e merr **Kryetari i Bashkisë Z.Beci**, i cili shpret se problemi që paraqitet është më i madh se kaq sepse nuk është e thjeshtë që të ngrihen strukturat funksionale për një kohë të shkurtër. Kazanët nuk pastrohen në zonën në fjalë sepse është i pamundur kalimi i makiës prapa pallatit. Nuk është zgjidhje që përfundon me një ndërhyrje. Jemi në proces sa i perket strukturimit, kurse Policia bashkiake është sfidë më vete dhe jemi në një proces strukturimi i të gjithë kësaj drejtorie. Po ashtu duam të vendosim disa prioritete për zonën pa dashur të paragjykojmë. Do të fillojmë me procesin e administrotorëve zyrtarë të pallateve por edhe ky është një proces që do kohën e tij. Edhe për gjobat është dashur të respektohet burokracia për të arritur të vendosim një rregullore të mirëpërcaktuar për të rregulluar këtë sektor.

Z.Bahri Muja, banor lagjja Guerrile (shtëpiat e bujqve) shprehet se:

1. Nuk ka ndriçim publik tek rruga nga rotonda tek Zooteknika.
2. Rruga tek 21 qershori ka rreth 100 – 200 për asfaltim.
3. Ka nevojë edhe për sinjalistikë horizontale.
4. Të vendoset një pikë grumbullimi mbetjesh pranë shtëpisë së bujqëve.

Gjithashtu ai sugjeron të bëhen takime me kryetarët e lagjeve për të dërguar propozimet dhe nevojat më shpesh.

Znj.Eri Lacej, drejtoreshë, shkolla “Ismail Qemali” shprehet se arsimi duhet të jetë një prioritet i Bashkisë.Ajo shton:

1. Infrastruktura e shkollës brenda ka nevojë për ndërhyrje.
2. Instrastruktura sportive po ashtu.
3. Oborri i shkollës ka palestrën e universitetit duke krijuar probleme me hyrje - daljet e studentëve dhe kontaktit mes nxënësve. Ideja në fillim ka qenë që kjo palestër të jetë edhe në funksion të nxënësve por nuk lejohemi që të përdorim këto ambjente. Është një ambjent që mund të shërbeje shumë si për nxënësit ashtu edhe për komunitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

4. Rruga pranë shkollës ka nevojë për sinjalistikë shtesë sepse ka shumë nxënës por dhe kalimet e makinave krijojnë situata problematike. .
5. Në lidhje me mbetjet kemi një pikë grumbullimi shumë pranë derës së shkollës, por mbetet problem ndërgjegjësimi i banorëve të cilët vijojnë të hedhin mbeturinat pranë derës së shkollës ose jashtë kazaneve. Kërkoj një takim edhe me kryetarin e lagjes për këtë pikë.

Përgjigjet **Kryetari Z.Beci**, i cili shprehet se jemi në proces bashkëpunimi me GIZ sa i perket ndërhyrjes së sinjalistikës pranë të gjitha shkollave. Po ashtu kërkojmë bashkëpunimin tuaj në lidhje me procesin e mbetjeve sepse çfardo pune të bëjë Bashkia pa ndërgjegjësimin e banorëve do ishte e kotë. Jemi në prag të miratimit të rregullores për gjobat ndaj hedhjes së tyre. Kërkoj bashkëpunim edhe nga mësuesit dhe ju për të ndërgjegjësuar nxënësit dhe banorët në lidhje me pastrimin.

Z. Fatjon Hoxha, përfaqëues i lagjeve Zogaj dhe Shirokë.

1. Rruga e Shirokës gjatë sezonit turistik apo fundjavave bllokohet dhe duhet bashkërendim më i mirë me policinë për këtë situatë.
2. Ka nevojë për asfaltimi rruga e peshkatarëve .
3. Po ashtu edhe rruga e Kampit.
4. Sa i përket turizmit dhe mjedisit duhet bërë pastrim i përgjithshëm i bregut të liqenit.
5. Qendra shëndetësore ka shumë fluks dhe ka nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë.
6. Sugjeron të investohet dhe zhvillohet sektori i sportit sidomos noti në zonën e Shirokës.

Z. Rasim Hasani, banor lagjja Ahmet Haxhija (Ndocej – Udhakryq) thotë se ka nevojë të verifikohet asfaltimi i kryqëzimit dhe kanalizimet e ujrave të zeza, po ashtu edhe rrjeti ujësjellës në rrugën e livadheve.

Z. Andi Halluni, banor lagjja nr.1 shprehet se:

1. Siç është sistemuar ura e Bahçallekut të ndërhyhet edhe në urën e re të Bunës.
2. Të ndalohet kalimi i motorëve në këeë urë.
3. Ka gjithmonë problem tek zona e sallahanës për kalimin e kalimtarëve.
4. Kazanat e mbeturinave pranë varrezave në Shirokë duhet verifikuar situata dhe të bëhet pastimi i tyre.
5. Sinjalistika tek Kryqëzimi pranë Bixhistenit është shumë problem dhe krijon rrezikshmëri për banorët dhe kalimtarët.
6. Tek pjesa e bypassit ka çdo ditë djegie gomash duke krijuar ndotje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Përgjigjet **Z.Altin Salihi** duke thënë se sinjalistika tek ky kryqëzimi ekziston por nuk respektohet nga banorët dhe kalimtarët.

Z.Skender Taipi shprehet po ashtu se në rrugën Hasan Podgorica pastrimi i koshave nuk ka frekuencë të mjaftueshme dhe bëhet shumë problem ndotja. Po ashtu edhe tek rruga Et'hem Kazazi e njëjta situatë. Ai shton se :

1. Kapakët e pusetave në unazë duhet të zëvendësohen dhe verifikohen ato që janë të dëmtuar.
2. Të bëhet nga ndërmarrja e ujësjellësit lidhja e ujit të pijshëm në këto dy rrugë.
3. Në rrugën Et'hem Kazazi kanë filluar punimet por ka nevojë për asfaltim sepse është bërë vetëm ndërhyrja për kanalet e zeza.
4. Problematikë tjetër është edhe rrjeti i energjisë.

Znj.Vildana Gushta ,banore Rajoni nr.1

1. Rruga Xhemal Naipi duhet të jetë prioritare sepse ka shumë banorë por ka nevojë për një fond të konsiderueshëm, pasi duhet ndërhyrje edhe në kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza.
2. Ka edhe rrugica të vogla që ka nevojë për riparime si: rruga Balej dhe rruga e Anamalëve

Znj.Brilanda Zoga, banore në lagjen Ahmet Haxhija shprehet po ashtu se edhe rruga Hysen Kurti ka nevojë që të asfaltohet.

Z.Kujtim Cuni , banor lagjia Guerrile, Kiras thotë se:

1. Prapa ish-shkollës veterinarë ka një hapësirë që mund të bëhet park lojrash apo ambjente pushimi për fëmijët dhe banorët pasi në atë zonë nuk ka as ambjente sportive dhe as rekreative.
2. Infrastruktura nga zooteknika deri në livadhe ka problem, një pjesë e cëhtë e pashtuar duhet ndërhyrë edhe në rrugicat e brendshme.
3. Ujërat e zeza nuk kemi kanalizime.
4. Sinjalistika në këtë zonë mungon dhe duke qënë se lidhet me bypassin shpesh futen edhe kamion duke bllokuar dhe rrezikuar zonën.
5. Tek e njëjta zonë edhe kazanet e mbeturinave duhen shtuar sepse e gjithë zona e ish-Zooteknikës ka vetëm 3 kazanë, dhe janë të pamjaftueshme.

Znj.Dhurata Tyli shprehet se ka 5 muaj që punohet dhe po bëhet një punë e mirë për mbetjet por ndërgjegjësimi i popullsisë është kryesorja. Ajo shton se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

1. Punonjësit që mbledhin mbetjet duhet të pastrojnë edhe perreth kazanave.
2. Gjelbërimi, problem i trajtuar edhe me parë, duhet të nderhyhet tek pemët dekorative dhe të priten sepse krijojnë edhe rrezikshmëri.
3. Zënia e hapsirave publike vazhdon të jetë problem më vehte, katet e para të pallateve kanë bllokuar hyrjet në blloqet e pallateve dhe kur ka emergjenca krijohet shumë problem për zjarrfikse apo ambulancë.
4. Korsia e biçikletave është një ndërhyrje për tu vlerësuar.
5. Uji I pijshëm keqpërdoret nga përdoruesit.
6. Linjat urbane duhen të kenë rimbursim për invalidët .
7. Mjediset publike (Velipoja), të ketë vemendje të shtuar përdorimi i zonës së plazhi.

Po ashtu pranë furrës së bukës Jahja (5 katëshi, Xhabije) është shumë problematike zënia e hapësirës publike, aty rruga hyrëse për në pallat po zihet nga një privat. Duke qenë se banojmë pranë rrugës në bëhet ndotje akustike nga makinat që kalojnë. Edhe korsia e biçikletave përdoret nga motorët duke kriju rrezikshmëri për përdoruesit e biçikletave.

Fjalën e merr **Kryetari i bashkisë Z.Beci** i cili shprehet se këto ditë do të fillojmë asfaltimin e rrugës nga Argenti deri në Perash. Kështu që për rajonin 1 kemi disa ndërhyrjet të rëndësishme. Sot është shpallur edhe tenderi për hyrjen e Shkodrës, siç e dini jemi në proces të fillimit për veshjen me kapotë për pallatet aty.

Z. Zija Meti, banor Bahçallek shprehet se:

1. Shkolla Bahçallek ka nevojë për 20–30 metra rrugë asfaltim për të eliminuar përmytjen.
2. Kazanat prapa shkollës duhen të hiqen sepse krijojnë papastërti të madhe.
3. Nga Hotel Ambassador deri në rrugën nacionale nuk kemi ku ecim për mungesë të një korsie biçikletash.
4. Po ashtu kemi shumë problem me pajisjen me dokumenta pronësie.

Kryetari sqaron se është e pamundur të vendoset sinjalistikë horizontale në rrugë nacionale.

Manjola Tuzi, banore Xhabije thotë se:

1. Në shkollën Ndre Mjeda është shumë problem rregullimi i oborrit, pasi grumbullon shumë ujë duke e përmytur atë. Kalimi bëhet i pamundur.
2. Ka plot problem me tualetet apo me lageshtirën e shkollës Ndre Mjeda.
3. Për autobuzin që tashmë nuk kalon në Xhabije duhet gjetur një zgjidhje sepse eëhtë shumë distançe nga Xhabija për në Perash.

Kryetari përgjigjet se është prioritarë shkolla Ndre Mjeda dhe do përpiqemi të ndërhyjmë patjetër. Do të përpiqemi sipas prioriteteve dhe fondeve të identifikojmë ndërhyrjet në të gjitha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

zonat. Jemi në komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë përsa i përket investimve me mbeshtetjen e tyre.

Znj.Valbona, zv/ drejtore shkolla Ndre Mjeda thotë se kemi nevojë për ndriçim pranë kësaj shkolle sepse mësimin e bëjmë me turne.

Aldi Saraci , banor rruga e Tisazhit thotë se:

1. Kemi problem trafikun dhe propozoj që rrugicat e vogla të jenë me një sens në oraret e pikut.
2. Sinjalistika në rrugët kryesore të shtohet dhe të plotësohet pasi ka zona ku mungon, si p.sh në unazën lindore ashtu edhe perëndimore.

Kryetari, sqaron se janë bërë disa ndërhyrje të vogla përmes tabelave që përmirësojnë trafikun. Por është e nevojshme të përfundohet studimi për të gjithë mobilitetin e qytetit. Në Unazat e qytetit është e domosdoshme që të bëhet rrjeti i biçikletave si për atë lindore dhe perëndimore. Jemi në diskutim për të vendosur këtë rrjet biçikletash për të për të vijuar pastaj me zonën e Rusit duke krijuar një rrjet të mirëfilltë për të gjithë përdoruesit.

Znj.Gjenovefa Kraja, banore Xhabije (5 katshet)

1. Mendon se duhet nje çerdhe për zonen e Xhabijes sepse vetëm kopshti i Sorosit nuk mjafton.
2. Oborret e shkollave të cilat janë pronësinë e Bashkisë duhet të mund të përdoren gjate pasditës apo ditëve të pushimit nga fëmijët për të luajtur sepse nuk ka vende publike.
3. Të krijohet hapësire për moshën e tretë ku ëe mund te kemi mundësi për të kaluar kohën.

Z.Alban Alibali, banor rajoni nr. 4 shprehet se në Qafë dhe Ajasëm nuk është investuar me vite , konkretisht:

1. Nga Ura e vezeve deri në Ajasëm.
2. Ujërat dhe kanalizimet e ujrave të bardha e të zez.
3. Parmakët për urën e Qafës.
4. Tubat e ujësjellësit, janë vendosur në zonë por nuk janë në funksion.
5. Ndriçimi i zonës.
6. Barrierë mbrojtëse për rrugën sepse është e rrezikshme.

Andi Bilali, banor lagjia Tophane shprehet se:

1. Ka nevojë për ndërhyrje në trotualet në të dyja anët e rrugës.
2. Shkolla ABC ka pallate 2 kateshe me nje shesh mes tyre që ka mundësi të rikualifikohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Mirel Miriaj, banor Zogaj pyet se:

1. kur fillon rruga Shirokë -Zogaj dhe sa do të zgjasë zbatimi i saj?
2. A është koordinuar ndërhyrja me OSHEE për të bërë njëkohësisht edhe rrjetin e energjise elektrike?
3. A mund të diskutohet me firmën që puna të fillojë nga Zogaj dhe jo nga Shiroka (sepse po filloi nga Shiroka krijohet problem duke penalizuar të gjithë zonën)

Përgjigjet Kryetari duke thënë se rruga duhet të fillojë nga Shiroka por do ta diskutohet sepse ka kuptim edhe propozimi juaj, po ashtu brenda projektit është e parashikuar edhe pjesa e rrjetit elektrik. Nuk mund të them saktë se kur fillon zbatimi i këtij investimi por mendohet të ketë një afat 1 vit e gjysëm zbatimi.

Znj.Uarda Gjekaj shprehet për rrugën Hamz Kazazi, drejtimi nga Parruca në Zdrale se duhet ndërhyrë se :

1. Lirimi i trutuarëve akoma nuk po funksionon .
2. Të minimizohen telat e varur të internetit, energjisë etj. gjatë zbatimit të rikualifikimit të fasadave.
3. Të bëhet një ndërhyrje për sa i përket kateve të para, tek ato biznese që kanë tuba shkarkimi të tymrave të cilat nuk janë të vendosura sipas kritereve të ligjit.
4. Po ashtu ka nevojë për asfaltim 20 metra rrugë pranë Degës së thesarit dhe Drejtorsë Rajonale të Tatimeve pasi krijon problem përmbytjeje dhe aksesit në institucion.

Znj. Eljona Shkrela, këshilltare e bashkisë shpreh shqetesimin e komunitetit katolik që frekuenton Kishën e Zonjës, duhet që transporti urban sidomos gjatë periudhës kur frekuentohet Kisha e Zonjës të jetë me orar me të zgjatur

Z.Angjelin Pjetri shprehet se kanë nevojë për vlerësim dhe ndërhyrje rruga Selim Bushati pranë ish – Zooteknikës dhe pularisë dhe shtimin e koshave të mbeturinave.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Rajoni nr.2.

Data : 19.10.2023

Ora :15:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 64, nga të cilat 26 gra, dhe 38 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Vjollca Tafili, banore lagje nr. 2 shprehet se në rrugën Ing. Gjovalin Gjadri duhet të vihet në efikasitet lulishtja pranë bllokut të pallateve të përndjekurve politik sepse për momentin ajo po përdoret si vend parkim dhe duhet ndërhyrë nga bashkia për ta kthyer në një ambjent pushimi. Gjithashtu për mbetjet nuk ka hapësirë mjaftueshme për kontenierët e caktuar. Po ashtu ajo kërkon që të rikthehet gjelberimi pranë trotuareve dhe të shikohet zënia e hapësirave publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Sqaron Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Luli, i cili thotë se jemi në proces të miratimit të rregullores për zënien e haësirave publike përmes të cilës do të kontrollohet dhe rregullohet situata e shfrytëzimit të këtyre hapësirave.

Z.Sander Drangu, banor lagjja nr. 2 merr fjalën dhe thotë se në zonën e Kirasit pas Poçerisë që prej vitit 2005 kemi shumë problem me rrugën, ndriçimin dhe ujësjellësin në zonë. Jemi rreth 20 – 30 shtëpi banimi. Edhe në rrugën Mehmet Xhelil Fishta mungojnë kanalizimet, as ndricim dhe as rrjet ujësjellësi. Linja e ujësjellësit është afër me rrugën tonë por nuk lejohet lidhja me këtë rrjet.

Z.Ditmir Thikaxhija, banor lagjja Fahri Ramadani shprehet se në zonën e tij të banimit mungon një kënd lojrash, një ambjent pushimi për moshën e tretë. Ai shton se shitësit ambulant nga Universiteti deri tek shkolla 10 korriku, krijojnë problem në zënien e trotuarit. Duhet gjetur një zgjidhje edhe për to. Edhe qendra shëndetësore duhet rikonstruktuar, duke shtuar ndriçimin dhe pastërtinë në zonë.

Znj.Suela Durraj, banore rruga Memej lagjja nr. 2 shpreh shqetësimet e zonës së saj:

1. Në rrugën Memej ka një numër të madh banorësh dhe është i nevojshëm shtimi i koshave sepse ka edhe mbetje që nuk duhen hedhur në këto kosha. Duhet të ketë një plan për të gjithë qytetin e Shkodrës në vendosjen e koshave si dhe të ketë një orar për hedhjen e mbetjeve. Mundësisht të punohet sa i perket ndërgjegjësimit dhe mendësisë së banoreve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve duke filluar nga shkollat dhe nxënësit për të vijuar pastaj me banorët.
2. Të kemi një strukturë ku banorët e Shkodrës të kenë një kontakt për të komunikuar qytetarët sa i perket mbetjeve urbane, inerte apo gjelberim të banorëve. Shërbim i cili mund të jetë i tarifuar edhe nga Bashkia.
3. Edhe pranë shkollës “Oso Kuka” duhet vendosur sinjalistika dhe të ketë kamera për monitorimin e kësaj zone.
4. E gjithë zona rreth shkollës, ka probleme me pastrimin apo parkimin e mjeteve.
5. Në zona të ndryshme të qytetit ka pemë dhe shkurre që dalin në rrugë e trotuare prandaj duhet të ketë një vëmendje më të shtuar për shërbimin e gjelberimit.
6. Gjithashtu ndërtesat dhe lejet që jepen të jenë me të lidhura me arkitekturën e qytetit.
7. Rruga e gjereë, bulevardi Bujar Bishanaku mbushet plot kartona dhe mbetje të lëna nga bizneset e zonës dhe janë shumë problematike, ka shumë mbetje që mund të jenë të riciklueshme dhe duhet të bëhet një takim me këto biznese për ti orientuar drejt riciklimit të këtyre mbetjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Shkodra duhet të jetë një nga qytetet shembull përse i përket menaxhimit të mbetjeve për të përmbushur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Znj.Ina Xhakoni, përgjegjëse në drejtorinë e Shërbimeve Publike shprehet se zonja ka shumë të drejtë me të gjitha propozimet e saj. Ne kemi realizuar një dëgjese sa i përket menaxhimit të mbetjeve urbane dhe jemi në proces të miratimit të rregullores për menaxhimin e mbetjeve duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithëve. Duhet bashkëpunim mes bashkisë dhe banorëve e bizneseve për të bërë të mundur eliminimin e situatës së ndotjes. Janë përcaktuar kundravajtjet dhe gjobat për shkelje të kësaj rregulloreje. Kjo rregullore është tashmë e publikuar. Duke përcaktuar dy fasha orare për hedhjen e mbetjeve.

Banore, pranë zonës së ish-Zooteknikës kërkon të ketë një dalje në bypass nga rruga Pecaj.

Zv/ kryetari Z.Onid Bejleri shprehet se në pjesën e bypassit nuk mund të ndërhyjë Bashkia por duhet të komunikohet me ARRSH. Jemi në dijeni të problemit dhe po mundohemi të gjejmë një zgjidhje.

Z.Fatmir Dekovi, banor lagjja Partizani thotë duhet verifikuar një rrugicë prej 140 metrash në rrugën Përparimi pasi ka nevojë për ndërhyrje.

Z.Rubin Borshi, administrator rajoni nr.2 shprehet se jemi në dijeni të problematikës dhe për pak kohë do të kemi mundësi të ndërhyjmë.

Z.Alfons Pecaj, banor rruga Shefqet Muka thotë se:

1. Janë 4 pallate me rreth 80 banorë në këtë rrugë, ka nevojë për mirëmbajtje të rrugës si dhe rrjetit ujësjellës kanalizime (ka patur ndërhyrje nga ujësjellësi por rruga nuk është rikualifikuar) janë rreth 50 – 60 metra linear.

Zv. Kryetari Onidi, shpreht se sot ne jemi pjesë e një pakete investimesh sa i përket asfaltimit të disa rrugëve, jemi duke filluar me bulevardet kryesore por do të vijohet me rikualifikimin e rrugicave në të gjithë qytetin. Ka një pjesë rrugësh që kanë nevojë edhe për sistemim të rrjetit të kanalizimeve dhe ka nevojë për pak kohë deri në realizimin e tyre. Jemi në dijeni edhe për dëmtimin e rrugëve nga ujësjellësi dhe OSHEE dhe me krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike do të kemi mundësi të bëjmë ndërhyrje në këto problematika.

Z.Myzafer Vorfa, banor lagjja Dudas kërkon verifikimin e rrugës nga kufizimi i rrugës Bujar Bishanaku në rruga Mehaj. Është një rrugë ku nuk është ndërhyrë prej 30 vitesh.

Të njëjtin shqetësim ndan edhe **Znj.Arbona Galici**. Ajo shprehet se janë shume banorë dhe ka edhe biznese pranë kësaj rrugice dhe duhet të ndërhyhet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Edhe **Z.Dilaver Cufi** , banor lagjja Partizani kërkon asfaltimin e rrugës rreth 150 metra linear dhe ndriçim të kësaj rruge. Gjithashtu shpreh edhe problematiken për qentë e rrugëve.

Z.Dilaver Cufi , banor lagjja Partizani shprehet se edhe rruga në fjalë ka nevojë për asfaltim rreth 150 metra linear dhe ndriçim. Edhe shkolla 10 korriku ka mungesë të tualetëve. Gjithashtu ai shton edhe problemin për qentë e rrugëve.

Z.Perparim Ceka , banor lagjja Dergut tek blloku i pallateve pranë rrugës së Tafiliceve shprehet se :

1. Hyrja në këtë bllok pallatesh bëhet e vështirë duke pasur edhe dy shkolla afër, ka shumë fluks makinash dhe kalimtarësh. Duhet gjetur një zgjidhje për ne rezidentët aty.
2. Janë bërë dy ndërhyrje por akoma ka nevojë të largohen tregtarët ambulant të rrobave të përdorura që zënë hapësirën publike.
3. Hapsirat publike mes pallateve janë të gjitha të zëna, jemi 6 pallate dhe nuk kemi një hapësirë të përbashkë një kohë që vendi shfrytëzohet për vëndparking.

Znj.Vjollca Jahja përgëzon për dëgjuesen që po ndërmerret por shprehet se:

1. Problematik për të është tregu i Rusit, si për kushtet e tregtimit por edhe për zënien e hapësirave. Duhen verifikuar kontratat dhe kushtet e plotësuar nga tregtarët.
2. Tjetër shqetësim është emërtesa e rrugës ku ajo banon, sipas saj emri nuk përfaqëson dhe nuk personifikon asgjë në lidhje me lagjen.
3. Ndriçimi publik është në rregull por të verifikohet zona pranë shkollës Përparimi që ka nevojë të ketë një hapësirë publike dhe rekreative.

Zv/kryetari Z.Bejleri përgjigjet se përsa i përket tregut të Rusit jemi në fazën e riprojektimit të tij për kushtet aktuale, duhet që të presim përfundimin e investimit në mënyrë që edhe AKU të bëjë kontrollë dhe përmirësim të higjenës në këtë treg.

Edhe **Kryetari i Këshillit** sqaron në lidhje me emërtimin e rrugës, që shumë shpejt do të ketë një rregullore që do të përcaktojë ndryshimet e propozuara.

Z.Engjell Radohina merr fjalën dhe shpreh shqetësimet e tij si banor i rrugës Qemal Dracini duke thënë se:

1. Rrugica që lidhet me bar Exalko, ka tabelë të ndalim qarkullimit por duhet të verifikohet teknikisht sinjalistika. Si dhe një shtyllë tensioni që nuk lejon kalimin për në sheshin e pallatit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

2. Në këtë pallat jetojmë 5 familje, që kemi të sëmurë dhe është e nevojshme që të kemi nderhyrje nga ana e Bashkisë sepse ndërtuesi i pallatit nuk ka respektuar për lejen kërkesat për PAK.
3. Po ashtu blloku i pallatit ka një hapësirë publike ku nuk mund të kalohet sa here që ka rreshje.

Ai shprehet se është i gatshëm të ndërhyje dhe ta bëj vetë investimin por vetëm të lejohet nga Bashkia. Po ashtu ka një pretendim pronësie për sheshin e pallatit dhe nuk lejojnë që të investojmë.

Zv /kryetari thotë se do të verifikojmë këtë situatë. Për më tepër secili nga pallatet me paketën e re do të ketë edhe administratorin e zyrtarizuar të tij, i cili doë reflektojë për bashkinë problematikat e ndryshme.

Fjalën e merr **Zv/ drejtori i shkollës 10 Korriku** (Skenderbeg), i cili shprehet se kanë shumë problematika|:

1. Godina ka vetëm një tualet
2. Klasat kanë nevojë për rikonstrukcion, sidomos kati I
3. Instalimet elektrike
4. Dyer, dritare etj.

Administratori i rajonit **Z.Rubin Borshi** thotë se jemi në dijeni të problematikës dhe është në proces ndërhyrja dhe realizimi i projektit. Ka numër shumë të madh nxënësish dhe shumë shpejt do të realizohet kërkesa juaj.

Znj.Emiljana Kapija, banore rajoni nr. 2 thote se:

1. Gjithashtu kemi problem në këtë shkollë sistemin e ngrohjes.
2. Si dhe stolat në oborrin e shkollës.
3. Rrugë Corraj ka shumë probleme me ujësjellësin.

Z.Muhamer Vuci, banor i Lagjjes Kiras shprehet se afër xhamisë së zonës ka shumë ndërtesa dhe asnjë hapësirë publike . Gjithashtu zona ka nevojë edhe për sistemim. Po ashtu të shihet mundësia e bashkëpunimit me donator.

Banore, Lagjja Rus merr fjalën dhe ngre problematikat e saj:

1. E gjithë zona e Rusit ka shumë ndërtime pa leje dhe një shfrytëzim pa kriter të hapësirës duke mos lënë mjedise publike për banorët.
1. Qytetarët e zonës Rus meritojnë të kenë hapësira pushimi dhe të minimizohen zhurmat dhe kaosi në zonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Lul Lekaj, pjesë e bordit të shkollës Shkollës Skenderbej (10 korriku) :

1. Mbetjet dhe koshat e mbeturinave tek kjo shkollë janë pranë derës së shkollës dhe kjo është shumë problematike. (ose të spostohen ose të jenë disi të mbuluara).
2. Mjediset e brendshme të shkollës janë investuar privatisht (nxënës dhe prind) por kjo është shkollë publike, duhet të investohet nga Bashkia.

Znj.Vilma Basha po ashtu thotë se:

1. Tokat e zaptuara nga ana e kateve të para të pallateve krijojnë problem për kalimin e zjarrfikëseve dhe ambulancës (pallati në rrugën tek policia)
2. Duhet të vendoset një rotondo tek zona e merkatës dhe rrugës Pogej.

Edhe kryetari i bordit i kopshtit i shkollës 10 korriku shton se kanë investuar vetë, dhe duhet të kenë mbështetjen nga Bashkia. Po ashtu ato kërkojnë të ndahet kopshti nga shkolla që të mos përzihen fëmijët e kopshtit me nxënësit e shkollës.

Z.Isa Çelepija, banor tek rruga Lek Dukagjini shprehet se para pak ditësh kanë filluar punimet e ujësjellës kanalizimeve por ka sërish nevojë për ndërhyrje në këtë zonë sa i përket kanalizimeve. Ai shton se ka projekt për rikualifikimin e oborrit të pallatit, i cili nuk është zbatuar pasi ka pretendim pronësie në këtë oborr. Nuk dihet akoma se kur mund të ndërhyhet në këtë bllok pallati. Në rrugën Lek Dukagjini ka edhe hapësira të tjera mes pallateve që duhen rikualifikuar.

Z.Gëzim Podgorica , banor i lagjes Lek Dukagjini shpreh të njëjtin problem përse i përket sheshit të pallatit. Në këtë rrugë edhe kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza janë të bashkuara duke krijuar ndotje.

Zv/Kryetari Z.Bejleri thotë se janë në dijeni të kësaj problematike dhe do verifikohet situata deri në zgjidhje të saj.

Përfaqësuese, e shkollës Azem Hajdari shprehet se oborri dhe rruga pranë shkollës është pa kanalizime dhe ka shumë ujë sidomos kur ka rreshje. Gjithashtu ajo shton edhe një tjetër shqetësim në lidhje me koshat e mbeturinave përballë spitaleve, të cilët janë të vendosur në një hapësirë të gjelbër.

Znj.Rozafa Zmijani, banore në rrugën Lëvizja e Postribës shprehet se më së shumti ka propozime për përmirësimin e imazhit të qytetit si p.sh:

1. Rreth rrotullimi qendër -Rus deri në Dobraq duhet të ketë mirëmbajtje të gjelbërimit rrugor.
2. Rreth rrotullimi ish 5 Heronjt të ketë një ndërhyrje vitalizuese dhe më të bukur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Në rrugën nga ish 5 Herojt deri në Rus mungon një ndarje dhe gjatë ditës krijohet shumë trafik sepse të gjithë duhet të shkojnë deri në rreth rrotullimin Rus. Duhet të mendohet një zgjidhje.
4. Po ashtu për shkollën Skenderbeg (10 korriku) është shkollë e madhe, në një lagje me shumë banorë dhe po të jetë e rikualifikuar dhe me kushte të mira të gjithë do mund të dërgojnë fëmijët aty.
5. Gjithashtu hapësira e jashtme të jetë me kënde sportive.

Z.Andi Halluni, banor rajoni nr. 2 vijon me shqetësime lidhur me shkollën Skenderbeg:

1. Është mbyllur palestra e shkollës dhe nuk e dimë cila është arsyeja
2. Po ashtu Shkolla Xheladin Fishta ka mbi 750 nxënës dhe vazhdon të funksionojë me gropë septike, pa rrjet të kanalizimeve të zeza.
3. Ka patur një oborr funksional prej 2600 metrash, i cili është marrë privatisht dhe duhet ti kthehet shkollës. Duhet gjetur një zgjidhje.
4. Pëmët dhe gjelbërimi duhet të kenë vemendje të shtuar në unazë.
5. Gjithashtu tek unaza perëndimore duhet të ndërhyhet sa i perket pucetave.
6. Edhe koshat pranë çerdhjes -kopshtit Tom Alimhilli duhet të spostohen.
7. Nga rruga Hafiz Sabri Koci deri në shkollën Oso Kuka duhet të jetë me një sens kalimi, së paku gjatë një orari të caktuar.

Z.Rubin Borshi sqaron se arsyeja e mbylljes së palestrës është sepse shkolla nuk ka mundësi të mirëmbaje dhe të vendosë në dispozicion një person që mirëmban dhe ruan këtë palestër. Kurse në lidhje me kanalizimet e shkollës Xheladin Fishta, kemi diskutuar dhe jemi në dijeni.

Zv/Kryetari po ashtu thotë se jemi duke përfunduar studimin e mobilitetit për të gjithë qytetin dhe kështu do mund të ndërhyhet me sinjalistikë në mënyrë për harmonizuar të gjitha rrugët.

Edhe **Z.Alban Hasani** shprehet se kemi patur edhe projekt propozime për shkollën Xheladin Fishta dhe duhet të shikohet me përparësi propozimi i bërë.

Z.Imeldi Sokoli, anëtar i Këshillit bashkiak thotë se Rajoni nr.2 përfshin të gjitha zonat tregtare të Shkodrës dhe si zemer ekonomike e qytetit duhet të shikohet me përparësi. Duhet të ketë projekte të integruara për këto akse rrugore dhe të konceptohen si rrugë tregtare. Përveç aksesit duhet të shikohen edhe rrugët e biçikletave apo fasadat e zonës duke e parë si një zonë BID, që rrit edhe atraksionin e blerësve dhe pse jo edhe turistëve. Për më tepër ai shton se:

1. Rruga Lek Dukagjini dhe rruga Nazmi Kryeziu ka shtëpi të vjetra dhe karakteristike të cilat duke u vitalizuar mund të përfshihen në hartën turistike të qyteti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

2. Mungesë tjeëer në rajonin nr. 2 është ajo e hapësirave të gjelbërta. (mund të identifikohen hapësira të vogla urbane shlodhëse brenda rrugicave apo lagjeve)
3. Parkingjet në bulevardet e rajonit nr. 2 duhet të kenë një zgjidhje për të gjithë fluksin e blerësve por edhe për banorët e rajonit nr. 2 si zonë tregtare.
4. Aksi rrugor Bujar Bishanaku mund të ketë një ndërhyrje estetike, pikërisht në përfundim të bulevardit. (kryqëzimi Kiras).
5. Edhe për rrugica pranë shtëpisë Hodo Beg Sokolit duhet gjetur mundësia e asfaltimit të kësaj rruge për ta bërë sa më të aksesueshme që shtëpia muze të jetë në hartën turistike të qytetit.

Banore - lagjja Vojo Kushi, rruga e Taflicëve thotë se parkingu që bëhet mes tre pallateve krijon përheër konflikte dhe duhet që Bashkia të ndërhyjë që ky mjedis të bëhet një hapësirë publike për të gjithë banorët. Krijon problemë edhe për aksesin e zjarrfikëseve apo ambulancës.

Zv/Kryetari përgjigjet se kemi qenë së bashku me kryetarin në këtë zonë dhe së shpejti do të ndërhyhet në këtë mjedis për ta rikthyer në publik.

Z. Nikolin Qafarena thotë se është në dijeni të ndërhyrjes për rrugën Ardian Kodra, rrugën Çlirimi, rrugën Dëshmorët e 12 dhjetorit por dëshiron të sugjerojë kujdes për rrjetin e kanalizimeve.

Përgjigjet përsëri **Zv/kryetari** i cili sqaron se FSHZH merr përsipër asfaltimin, ndërkohë Bashkia duhet të bëjë rrjetin e kanalizimeve. Prandaj vitin që vjen Bashkia do të punojë për rrjetin e kanalizimeve, për të vijuar me asfaltimin dhe çdo nevojë tjetër.

Përsëri **Z. Andi Halluni** shprehet se zona e rajonit nr.2 nuk ka asnjë ndriçues dekorativ për periudhën e Vitit të ri edhe pse ka popullsi të madhe. Është e nevojshme të kemi vemendje për sa i përket këtij pjese.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Rajoni nr.4.

Data : 25.10.2023

Ora : 15:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 38, nga të cilat 8 gra, dhe 30 burra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Zaim Camaj**, banor lagjja Manush Alimani , bldv. Mehmet Pashë Plaku I cili shprehet se tek pallati nr. 112/1 apartamenti 12 është dëmtuar suvaja ka rrezik për jetën e banorëve dhe kalimtarëve. Kjo është një ndërhyrje emergjente pasi paraqet rrezikshmëri të lartë. Duke qenë se po bëhen rikualifikime të pallateve me veshje kapotë kërkoj që edhe ky pallat të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

futet në listën e objekteve që do investohet. Është pallat në hyrje të bulevardit duke patur edhe impakt viziv për të gjithë.

Zv/Kryetari Z.Onid Bejleri shprehet se rajoni nr. 4 është përfitues për investimet në pallate për efijence energjie, një pjesë e pallateve ku do ndërhyhet është zona Parruce –Xhabije. Në një moment të dytë patjetër që edhe bulevardi Mehmet Pashë Plaku do ketë ndërhyrje. Megjithatë kjo është edhe detyrë e banorëve të pallateve sepse jo vetëm Bashkia duhet të ndërhyjë në mirëmbajtje. Me përcaktimin e administratorëve do të ketë edhe një formë tjetër menaxhimt të pallateve dhe ndërhyrjeve me bashkëpunimin e banorëve.

Znj.Bukurie Tuzi thotë se në Lagjen Vekshar, rruga Foljeta ka mbi 25 familje dhe nevojë emergjente për ndërhyrje.

1. Në prag të rreshjeve kemi problem me ujin që vjen nga kodrat dhe futet në oborret e shtëpive.
2. E gjitha lagjja Vekshar është me gropa septike dhe kemi nevojë për kanalizime të ujrave të zeza.
3. Mungon edhe ndriçimi i rrugës.
4. Ka nevojë për verifikim të nevojës për asfaltim dhe sistemim të rrugës.

Znj.Brunilda Dibra, banore lagjja Manush Alimani tek pallatet parafabrikat përballë shkollës së ndërtimit shprehet se:

1. Trotuari në njërin krah është i mjaftueshëm ndërkohë që trotuari në krahun e majtë mungon në shumë pjesë (pranë Medreses, pranë shkollës së ndërtimit etj.) Duhet të ndërhyhet tek bizneset për të liruar trotualet dhe të bëhet rikualifikimi i tyre.
2. Bumet në blvd. Mehmet Pashë Plaku janë të rrezikshme dhe burim aksidentesh prandaj duhet të rishikohen (të gjindet një mënyrë tjetër për kufizimin e shpejtësisë)
3. Fasadat e pallateve në këtë bulevard, i cili tashmë është hyrje kryesore e qytetit kanë nevoja të mëdha për rikualifikimin pse jo edhe me bashkëpunimin e komunitetit. Së paku lysterja e pallateve duhet të realizohet nga Bashkia.
4. Pusetat anësore të rrugës nuk kanë rrjeta dhe gjethet shpesh I bllokojnë ato. Duhet të vlerësohet nevoja për të vendosur rrjeta dhe siguruar që keto puseta të mos bllokohen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak **Z.Luli** sqaron se në këshill do të kalojë një rregullore sa i perket hapësirave publike ku çdo shkelje ndaj interesit publik dhe zënie të hapësirave publike do të ketë një përgjigje në këtë rregullore duke filluar nga gjobat dhe sistemimi i kësaj shtuate. Kurse në lidhje me gjelbërimin, operatori ekonomik që zbaton kontratën duhet që të zbatojë sipas rregullit edhe hedhjen e ketyre mbetjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Zv/Kryetar Z.Onid Bejleri shton gjithashtu se ka një ligj të veçantë që parashikon pjesën e ndërhyrjeve në mirëmbajtjen e pallateve dhe bashkëpronësisë ku mirëpercaktohet detyrimi i pronarëve për të mirëmbajtur fasadat e pallatit.

Z.Myzafer Shabani, banor në lagjen e vjetër Qafë thotë se janë lagje me shumë banorë dhe kanë nevojë për :

1. Ndriçim në zonën e tyre.
2. Kanalizimet e Ujërave të zeza dhe të bardha.
 1. Asfaltimin e 300 metra rruge.
 2. Ka nevojë për rrjet ujësjellësi sepse edhe pusët janë të dëmtuara tashmë nga ujrat e zeza dhe gropat septike.
 3. Edhe për investimin që po realizohet në Xhamin e Plumbit duhet të verifikohen kanalizimet e ujërave të bardha.

Znj.Albana Ndoja, zv/drejtore shkolla Kol Idromeno shprehet se gjimnazi funksionon me kohë të plotë dhe të pjesshme me rreth 400 nxënës, jemi drejtuar disa herë Bashkisë Shkodër për një investim në këtë shkollë sepse ka nevojë për ndërhyrje në suvatime, lyerje, shtrime etj. Nuk ka hapësira sportive dhe as mjedise informatike apo laboratore. Kemi gjithashtu nxënës PAK që nuk kanë mundësi akses në shkollë. Edhe sinjalistika pranë shkollës duhet të jetë me e mirë duke qenë se ka shumë fluks nxënësish. Për më tepër patrullimi nga ana e policisë duhet të jetë i vazhdueshëm sepse problematikat janë të shumta.

Kryetari i Këshillit Bashkiak shprehet se që me mandatin e kaluar kemi diskutuar nevojën për investim në këtë shkollë me vlerën e projektit rreth 800 mijë euro dhe është aplikuar pranë Min. së arsimit.

Z.Dritan Duhani, banor rajoni nr.4 shprehet se në rrugën ku banon ka një kolektor që sjell problematika të vazhdueshme, është i dëmtuar dhe bashkohen edhe ujrat e zeza me të.Po ashtu:

1. Ka nevojë për pastrim sepse nuk është ndërhyrë asnjëherë.
2. Duhet të mbyllet sepse është i zbuluar dhe krijon rrezik për fëmijët dhe banorët.
3. Edhe ndriçimi mungon në këtë rrugë.

Z.Alfred Luleta përgjigjet që është një pjesë e kolektorit që ka mbetur i zbuluar në vite, ka nevojë për projekt për të investuar dhe është prioritarë ndërhyrja në të.

Banor, rruga e Koplikve merr fjalën dhe thotë se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

1. Hyrja e pallatit nr.871, kati i parë i pallatit është i amortizuar dhe futen qentë endacakë atyduke krijuar shumë problem për banorët e pallatit, si për higjenën por edhe rrezikshmerinë.
2. E gjithë fasada e pallatit është drejt degradimit dhe duhet ndërhyrë për rikualifikimin e tij.

Tjetër shqetësim i tij është zona e pedonales së molos, nuk ka loja apo mjedise ku fëmijët mund të luajnë dhe të kenë hapësira pushimi.

Zv/kryetari shprehet se në lidhje me hapësirat publike kemi një projekt madhor për hyrjen e qytetit por edhe projekte për brenda lagjeve. Do shtohen kështu hapësirat sportive dhe të gjelbërta.

Z.Gani Leku, banor lagjia Qafë (pranë Kalasë) shprehet se rreth 200 metra rrugë drejt degës së dikurshme ushtarake ka nevojë për ndërhyrje. Po ashtu ka nevojë për,

1. Asfaltim dhe kanalizime.
2. Rrjet ujësjellesit sepse është i amortizuar.
3. Të vendosen edhe tabela orientimi turistike informuese për orientimin e turistëve.

Investimi në këtë zone ka shumë impakt si për banorët por edhe për numrin e lartë të turistëve që vizitojnë kalanë.

Z.Firdus Osmanaga, banor pranë pallatit përballë Jumbo shprehet se:

1. Sheshi i pallatit ka qenë i sistemuar dhe me hapësira parkimi por tashmë janë dëmtuar nga një privat dhe është vendosur edhe një kufizues.
2. Nuk ka hapësira parkimi për ne banorët dhe zona ka shumë fluks makinash nga bizneset, ndërkohë ne rezidentët nuk kemi hapësira parkimi.

Zv/Kryetari sqaron se është duke përfunduar plani i mobiliteti për të gjithë qytetin dhe është po vlerësohet mundësia për pajisje me kartë rezidenti.

Z.Muharrem Sakti, banor lagjia Qafë shprehet se:

1. Kanali i ujrave të zeza është problem emergjent për rrugën Qafë.
2. Gjithashtu edhe asfaltimi i rrugës, ku s'mund të kalojnë as makinat aq më pak zjarrfikëset apo ambulanca.
3. Ka nevojë për instalimin e rrjetit të ujësjellësit.
4. Të vendosen edhe kontenier për mbetjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Z.Arben Kallaci, administrator Rajoni nr.4 shprehet se e gjithë zona është për investim total të rrugës duke filluar me kanalizimet dhe tek asfaltimi. Ka rreth 40 familje dhe ndërhyrja është emergjente. Do të verifikojmë edhe me shërbimet publike mundësinë e vendosjes së koshave për mbetjet.

Z.Jetmir, banor në Draçin pranë nënstacionit elektrik, rruga Mehmet Gjyli shprehet se:

Jemi rreth 25-30 familje që kemi nevojë për të realizuar asfaltimin e rrugës në shërbim të këtyre familjeve. Po ashtu kemi nevojë për kanalizime të ujrave të bardha dhe të zeza.

Zv/Kryetari thotë se kjo rrugë është pjesë e investimit nga FSHZH dhe përpara asfaltimit do të bëhet edhe ndërtimi i rrjetit kanalizimeve.

Znj.Antonjeta Pero, banore lagjia nr. 4 shprehet se nuk kemi një çerdhe për fëmijët. Jemi lagje me shumë banorë. Në shkollën Ali Lacej mund të krijohen mjedise të krijuara përshtatshme për një çerdhe. Është një shërbim shumë i nevojshëm për familjarët dhe numrin e lartë të banorëve. Të shikohet mundësia e planifikimit të këtij investimi.

Znj.Kejda Mataj, drejtore shkolla 3 Dhjetori kërkon të verifikohet situata nga dr. përkatese për shtesë strukturë, vendosje të sinjalistikës dhe vënie në funksion të ashensorit dhe alarmit. Ajo shton se ka:

1. Problematika sa i përket rrugicës hyrëse - dalje të shkollës pasi ka nevojë për sinjalistikë vertikale dhe horizontale.
2. Është investuar për një ashensor dhe sistemi sigurie alarm nga zjarri por nuk është funksional. Kërkojmë që të verifikohet mundësia për të vënë në funksion këto dy investime të realizuara. Janë të domosdoshme këto dy investime për shkollën speciale.
3. Duhet të shtohet një punonjës mbështetës për kryerjen e shërbimeve ndaj fëmijëve.
4. Gjithashtu personi/ punonjësi mbështetës duhet të shoqërojë fëmijët edhe gjatë transportit sepse nuk mund të kryhet mbështetja e fëmijëve nga shoferi.
5. Kërkesë afatgjatë është rikonceptimi i kësaj shkolle dhe shërbimit që jepet në të sepse është një aset i nevojshëm për përfshirjen sociale në Shkodër. Duke qenë se ka ambjente mund të shtohen shërbime të ndryshme mbështetëse në këtë shkollë (logopedi, fizioterapi, kurse zhvillimi të fëmijëve etj.)

Z.Zamir Mallani, banor pranë ZVA Shkodër thotë se është pronar i një biznesi në krah të rrugës së biçikletave, dhe ndjehet i penguar nga korsitë e bëra të biçikletave sepse nuk ka akses në biznes ashtu edhe për furnizim. Po ashtu në pallati ku banon ka probleme me shkarkimet e ujrave të bardha të cilat depozitohen poshtë pallatit dhe ka shumë problem nga bashkimi i ujrave të bardha dhe ëe zeza duke krijuar probleme me higjienën dhe lageshtirën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Znj.Manjola Tuzi , banore në lagjen Xhabije shprehet se pranë Argentit janë dy servise makinash dhe një lavazh ku i gjithë sheshi është i dëmtuar dhe duhet rikualifikuar ose asfaltuar. Po ashtu edhe tek hyrjet e pallateve parafabrikate rruga mbushet me ujë, duke u bërë e pakalueshme.

Z.Muharrem Shkjau, anëtar i Këshillit Bashkiak shprehet se duke qenë vetë banor I këtij rajoni, vërej që zonat e Draçin, Tepe, Ajasëm, Lukuçesme, Vekshar kanë marr më pak investime se e gjithë Shkodra. Prandaj kërkohet vëmendje edhe për këtë pjesë të qytetit. Kërkoj nga ana e juaj që të shikohet ndarja e fondeve për keto lagje në asfetime, ndrçim , rrjete kanalizimesh dhe rrjete ujësjellësi. Të ngrihet komision për verifikimin në vend të infrastrukturës në këtë zonë dhe të bëhen reale nevojat e kësaj zone.

Znj.Brunilda Dibra kërkon që të vendoset një pikë kontakti për sa i përket marrjes së nevojave dhe ankesave nga ana e banorëve sepse jo të gjithë arrijnë të gjejnë kontakt interneti apo të vinë në Bashki.

Znj.Valjeta Golemi, Këshilltare Këshilli bashkiak dhe banore tek pallati me hark në bulevardin Mehmet Pashë Plaku shprehet se suvatimi ka shembje dhe ka rrezik për banorët dhe kalimtarët, duhet ndoshta me fondet e bashkisë të behet një ndërhyrje sa më shpejt pasi është ndërhyrje emergjente.

Zv/Kryetari përgjigjet se do shohim mundësinë për të investuar në këtë fasadë. Por edhe në vijim do të ketë edhe skema financimesh të tjera për të nxitur bashkëpunimin me privatin për ndërhyrje të tilla.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Rajoni nr.5.

Data : 24.10.2023

Ora :15:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 50, nga të cilat 10 gra, dhe 40 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Znj.Mimoza Livadhi**, drejtore e shkollës Edith Durham e cila shpreh shqetësimet e shkollës që ajo drejton:

1. Hidroizolimi I çatisë së shkollës është shumë problematik dhe krijon problem në infrastrukturë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

2. Ngrohja në këtë shkollë nuk funksionon dhe nuk është vënë në funksion asnjëherë kaldaja e cila është e instaluar. Duhet verifikuar situatë nga Drejtoria ekonomike e arsimit, vijojmë të kemi ngrohje me gaz dhe kjo është e rrezikshme.

Banor, lagjja Ndoc Mazi, Ruga Ndre Zadeja thotë se një rrugicë rreth 70 metra është pa ndriçim pranë ish fushës sportive (shkolla Miqesia) ka mbi 20 shtëpi në atë zonë. Po ashtu ai shton se ka nevojë për :

1. Asflatim
2. Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe verifikim i rrjetit të ujrave të zeza.

Kryetari i bashkisë **Z.Beci** shprehet se administratë e tij mbajti shënim ankesat dhe do verifikojë situatën, pasi jemi në proces të vendosjes së ndriçimit LED në qytet dhe do të kemi mundësi të vendosim ndriçues edhe në rrugën në fjalë.

Z.Nikolin Qafaren, përfaqësues i Shkollës Dëshmorët e Prishtinës shprehet se:

1. Ka që në 1998 që nuk është bërë asnjë ndërhyrje infrastrukture dhe shkolla ka shumë nevoja si të jashtme të fasadës ashtu edhe të ambjenteve të brendshme.
2. Kërkojmë një palestër për këtë shkollë (ka mjedise publike mjaftueshëm) sepse do ishte një investim me shumë vlerë edhe për nxënësit por edhe për banorët e zonës që mund të përdorin këto ambjente sportive.
3. Pjesa e rikualifikimit të shkollës është me prioritet sepse ka një degradim të vazhdueshëm të infrastrukturës.

Znj.Jona Leqejza thotë se për shkollën Dëshmorët e Prishtinës ka vite që diskutohet prandaj mendon se duhet të jepet përparësi ndërhyrjes në këtë shkollë.

Z.Anton Guri, rruga Fran Bardhi (lagjja 3 Heronjt) shprehet se rruga ky banon është shumë problematike rreth 250- 300 metra linear me rreth 25 shtëpi. Rruga është e pakalueshme si për banorët ashtu edhe fëmijët e shkollave. Ka nevojë për:

1. Kanalizime të ujërave të bardha e të zeza
2. Asfaltim
3. Ndriçim

Po ashtu edhe në rrugën Kalaja e Dalmaces është bërë asfaltim dhe kanalizime por ka nevojë për ndriçim akoma.

Kryetari i Bashkisë shprehet se nuk mund të përfundojmë të gjitha investimet menjëherë por sipas prioriteteve do të fillojmë buxhetimin për këto ndërhyrje sipas mundësive të fondeve. Do



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

donim të kishim një përmbledhje të problematikave dhe nevojave për të gjithë rajonin, ato që shërbejnë më shumë për të gjithë.

Z.Gjergj Martinaj, lagjja Skenderbeg, pas varrezave katolike, rruga e Martirëve është rrugë rreth 200 metra thotë ai dhe ka rrjet të ujërave të zeza por ska rrjet të ujërave të bardha e nuk as asfaltim.

Z.Ndoc Ashta, banor lagjja 3 Heronjt kërkon të verifikohen nevojat e rajonit p.sh:

1. Rruga Mirash Ivanaj dhe Gjon Gazulli.
2. Kanalizimet e ujërave të bardha dhe të zeza.
3. Degëzimit e rrugëve Mirash Ivanaj dhe Gjon Gaz.

Kryetari përgjigjet që është në proces të bëhet lidhja përmes Fondit Shqiptar për këto dy rrugë. Prandaj duhet të parashikohen të gjitha ndërhyrjet si të kanalizimeve edhe ndricimit

Z. Dodë Mehmetaj shprehet për disa problematika të zonës së bllokut të pallateve tek ish Fusha e Druve.

1. Pastrimi ka tashmë shumë ndryshim por në zonën në fjalë nuk ka një person që merret me pastrimin dhe ka nevojë të ketë vëmendje të shtuar.
2. Kanalizimet e ujërave të zeza janë bërë në 2017 por që atëherë ka patur probleme të investimit dhe duhet të verifikohet situata UKSH-ja duhet të verifikojë rrjetin.
3. Pastrimi tek zona e fushës së druve ka probleme sepse firma ose qytetarët hedhin mbetjet pranë Kirit.
4. Ka shumë fëmijë në këtë lagje dhe ka nevojë për hapësira publike sepse kendi i lojrave ekzistues nuk funksionon, ka një lulishte të madhe pranë zonës dhe mund të krijohet një kënd lojrash në këtë lulishte në shërbim të familjarëve.
5. Fasadat e pallateve të këtij blloku pallatesh duhet të jenë pjesë e rikualifikimit urban dhe me eficiencë energjie.

Tjetër banor shprehet se rruga e Pultit është e bllokuar që dy javë, duhet të hapet të paktën për emergjencat që kane njerëzit.

Kryetari sqaron se kjo është një segment ku duhen edhe 10 ditë për të përfunduar punimet e hapjes për hapjen e saj por që nesër do të dërgojmë inxhinier për të verifikuar situatën atje dhe për të bërë të mundur hapjen e një kalimi.

Po ashtu edhe në lagjen Mark Lula ka nevojë për plan urbanistik sepse ka mbi 6000 banorë dhe nuk ka asnjë ndërhyrje nga ana e Bashkisë. Kërkohej ndërhyrje në rrugët: Rozalej, Besa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

e Prekalit dhe Ernesto Koçi . Po ashtu nuk ka pastrim tek zona e bllokut të pallateve në të gjithë zonën.

Përgjigjet Znj.Ina Xhakoni, përgjegjëse pranë drejtorisë së Shërbimit publik në Bashkinë Shkodër dhe thotë se kjo është problematike edhe e banoreve dhe e bizneseve dhe me një rregullore do të mund të kemi kontroll dhe zbatim më të mirë të këtij shërbimi. Por sa i përket hedhjes së mbetjeve në breg të Kirit duhet që të kemi fakte rreth kësaj situate që të ndërhyjmë.

Z.Dode Mehmetaj shton se koshat e mbeturinave të vendosura nuk janë të mjaftueshëm sepse ndërrmarrja e pastrim, gjelberimit hedh mbeturinat e korries në kosha duke e përkeqësuar situatën.

Znj.Aurora Gjollaj, banore rruga Gjon Buzuku shprehet se :

1. Prej 2022 e në vazhdim nuk ka ndriçim duke filluar që nga rreth rrotullimi në Mark Lula.
2. Ka dy pallate pranë kësaj rruge që kanë nevojë për rikualifikim të fasadave pasi përbëjnë rrezik për sigurinë e banorëve.
3. Po ashtu edhe oborri i pallateve në këtë zonë mund të rikualifikohet dhe të shërbejë për banorët e zonës.

Z.Franc Gjeka, banor rruga Mehmet Shpendi thotë se :

1. Që prej rikonstruksionit të kryer në këtë rrugë ka një rrjet kanalizimesh të papërfunduar.
2. Mungon ndriçimi në rrugicat lidhëse.
3. Ka nevojë për asfaltim në rrugicat e kësaj rruge. (70 metra rrugica)
4. Ka nevojë gjithashtu edhe për sinjalistikë.

Ylli Marku, banor lagjja Mark Lula shprehet se ka mbi 15 vite që nuk kemi një hapësirë sportive për sa i përket **sportit të Ping pongut** dhe nuk lejohem të ushtrojmë këtë sport në mjediset sportive të SK.Vllaznisë pranë stadiumit. Kërkojmë të verifikohet funksionimi i këtij sektori me shoqatën që administron këtë disiplinë.

Z.Ndrek Vata thotë se rruga e unazës lindore në degëzim me rr.Rozalej ka problem me kanalizimet dhe asfaltimit.

Z.Orgest Permargjeka shprehet se kemi problem për sa i përket shpërndarjes së piklave të grumbullimit të mbetjeve sepse ka shumë banorë dhe ka nevojë për pika të tjera grumbullimit.

Z. Ina Xhakoni sqaron se duhet edhe dakortësimi i banorëve për këtë.

Z.Gjergj Sokoli shprehet se është emergjente vendosja e kazaneve në rrugët:

1. Rruga Milan Shuflaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

2. Rruga Mehmet Shpendi
3. Rruga Vllaznimi

Z.Tonin Cekliqi shprehet gjithashtu se fasadat e pallateve në këtë zonë janë të rrezikshme. Po ashtu edhe qendra shëndeësore në lagjen tonë ka nevojë për ndërhyrje infrastrukture.

Z.Prele Gjoni, banor Lgj.3 Heronjt thotë se rruga Qafa e Bishkazit dhe Mark Ndoj janë rrugë në proces por që nuk janë përfunduar. Janë shumë të amortizuara dhe kanë nevojë për kanalizime të ujrave të zeza dhe të bardha. Nuk ka as rrjet të ujit të pijshëm. Të shikohet mundësia për një nënkallim tek stacioni i trenit.

Administratori i Xhedis shpk shpreh disa kërkesa:

1. Të ketë një pikë për mbeturinat pranë supermarketit në lagjen Skenderbeg.
2. Të ketë vija të bardha, që janë emergjente pranë shkollës NDOC MAZI.
3. Edhe rruga Marin Bicikemi ka nevojë gjithashtu për vija të bardha.
4. Bumet në qytet janë të mirë por në rastet e fatkeqësive për ambulanca dhe zjarrfikëse duhet të verifikohen situatat e gjobave sepse janë të rrezikshëm.
5. Nga rruga e bicikletave kemi penalizim nga kjo ndërhyrje sepse nga shkolla pyjore deri tek Bixhisteni nuk ka përdorim të madh ndërkohë bizneset dëmtohen nga ky investim.

Z. Kastriot Docaj shprehet gjithashtu në lidhje me korsitë e biçikletave, pasi ai mendon se ka dëmtuar bizneset. Ai shton se edhe në rrugën 7 Shaljanet mungon asfaltimi .Duhet verifikuar rruga Gjon Leka, janë rreth 150 metra rrugicë ku mungon asfaltimi por edhe kanalizimet e rrugës. Nuk ka rrjet ujësjellësi pas pallateve Gjon Buzuku.

Znj. Karafili, shkolla Martin Camaj shpreh shqetësimet e shkollës së saj:

- Terraca dhe izolimi i saj është pjesor dhe me rreshjet e para ka probleme të lagshtirës.
- Nuk ka as ambjente sportive dhe as palestër në këtë shkollë.
- Ambjentet e shkollës përdoren nga institucione të tjera.
- Nuk ka oborr shkolle dhe asnjë hapësirë për nxënësit.
- Rruga hyrëse për në shkollë është e shkatërruar dhe nuk ka kanalizime.
- Në 2021 është vendosur një tabelë për ndalim e kalimit të makinave por është hequr duke rrezikuar sigurinë e nxënësve.

Z.Zef Gjini, kryetar i shoqatës së artizanëve dhe zejeve në Shkodër shprehet po ashtu për problematika dhe propozime nga artizanët dhe zejtarët:

1. Të festohet dita e artizanëve sic është bërë çdo vit.
2. Panairi i njësive administrative (per zhvillimin dhe promovimin e produktit lokal) .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Të përcaktohet një fond i cili shërben për promovimin e aktiviteteve të shoqatës së artizaneve dhe zejeve.

Zv/kryetar **Rudin Beka** përgjigjet se kemi në vëmendje sektorin e artizanatit dhe jemi duke e rikonceptuar formën e ekspozimit dhe promovimit të këtyre produkteve lokale, gjithashtu duhet që të jetë më gjithëpërfshirës me të gjithë artizanët dhe zejtarët në Shkodër për të dalë me një produkt unik. Kemi filluar punën për realizimin e ekspozitorëve ku do të mundeni edhe ju të ekspozoni produktet tuaja.

Z.Gjergj Sokoli shprehet se prioritet kryesor duhet të jetë Rruga Rozalej. Ka shumë rrugica në qytet ku janë realizuar kanalizimet dhe ndricimi por mungon asfaltimi. Si p.sh: Rruga Qëndresa 1915, rruga 7 Shaljanët e të tjera rrugë ku janë përfunduar të gjitha investimet por mungon asfaltimi. Gjithashtu sa i përket kazanëve të mbetjeve, Bashkia duhet të vendosë përfundimisht se ku do të vendosen koshat e mbeturinave.

Z. Dodë Mehmetaj thotë se tek banesat pas rrjetit të hekurudhës ka investime në rrugica të cilat kanë qenë selektive dhe nuk janë të përfunduara. Duhet që Bashkia të ndërhyrje dhe të përfundojë investimet.

Znj. Rrezarta Pode, anëtare e Këshillit bashkiak shprehet se:

1. Duhet shtuar nr. i çerdheve në këtë zonë duke para numrin e lartë të popullsisë.
2. Duhet kende fëmijësh.
3. Po ashtu qëndër për të moshuarit.
4. Shtim i hapësirave të gjelbert.

Z.Alma Mehmetaj, anëtare e Këshillit bashkiak thotë se:-

1. Përsa i përket ndërhyrjeve në lagjen Mark Lula për asfaltim duhet verifikuar situata edhe për ujin e pijshëm, mungon rrjeti i ujësjellësit.
2. Pranë shkollës Edith Durham ka nevojë edhe për sinjalistikë për rritjen e sigurisë së fëmijëve.
3. Tek kjo shkollë po ashtu është edhe qendra Harmonia dhe duhet të rritet kapaciteti i saj sepse kerkesat nga banorët janë të shumta.
4. Tek shkolla Dëshmorët e Prishtinës është shumë emergjente ndërhyrja.

Z.Alban, Specialist pranë Agjencia rajonale të mjedisit shprehet se tek vendstrehimet e pallateve të vjetra duhet të ndërhyhet disi nga Bashkia (pranë Isa Boletini) pasi ka ka mjedise që mund të rikualifikohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak Z.Luli falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : Njësia administrative Rrethina, Pult, Shalë, Shosh.

Data : 10.10.2023

Ora :12:30

Vendi: Pranë Komunës

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 52, nga të cilët 2 gra, dhe 50 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Taulant Shahmati**, drejtor i shkollës “Ismet Sali Bruca”fshatit Guci e re, i shpreh shqetësimet e tij:

- Infrastruktura e shkollës është e dobët nga mungesa e ndërhyrjeve.
- Mungojnë këndet sportive.
- Nuk ka hapësira publike dhe këto këndet sportive të shkollës mund të shërbejnë edhe për banorët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

- Nuk kemi shkollë të mesme ose profesionale.
- Kemi vetëm shkollë 9 vjecare.
- Ndërhyrja në shkollën Shtoj i ri është shumë emergjente pasi ka numër të madh nxënësish.

Znj. Mirela Mataj, mesuese Shtoj i ri shprehet se:

- Në zonë nuk ka çerdhe.
- Kopshtet janë në ambjente shumë të vogla dhe në varësi të shkollës.
- Mungojnë kendet sportive.

Z. Elson Berhani, specialist në Bashkinë Shkodër përgjigjet se kemi një projekt për qendër multifunksionale në zonën Rrethina ku mund të parashikohet realizimi i hapësirave dhe këndeve sportive dhe rekreative për femijët dhe moshën e thyer.

Znj. Rrezarta Pode, anëtare e Këshillit bashkiak merr fjalën dhe shprehet se:

- Infrastruktura dhe terrenet sportive të kopshteve dhe shkollave duhen parë si prioritet.
- Problem vazhdon të jetë ngrohja në institucionet arsimore të zonës.
- Ngruhja me gaz duhet eliminuar si dhe duhet të kemi kujdes me fikëset e zjarreve.

Z. Prele Doci, banor fshati Grudë thotë se:

- Kemi mungesë uji në Grudë.
- Kemi 3 blloqe banimi të cilat kanë nevojë për ndërhyrje në fasada.
- Qendra shëndetsore Prele Gjelloshi ka nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë.
- Kemi një treg privat për bagetinë, i cili ka nevojë për vëmendje sidomos në fundjavë nga policia bashkiake për të rregulluar trafikun.
- Pastrimi është shumë problematik në zonën tonë dhe kjo edhe për mungesë përgjegjësie nga ana e banorëve por duhet që edhe kryetarët e fshatit dhe administratori ta ketë në vëmendje.
- Në Grudë të re kemi hapësirë për një kënd të vogël lojrash për femijët dhe hapësirë për moshat e thyera. Duhet parë si mundësi për Bashkinë për të na ndihmuar me ndërtimin e tyre.

Mesues dhe banor, fshati Bregu i Lumit, Nj.A. Shalë merr fjalën dhe thotë se shkollë e zonës së tij ka mungesë infrastrukture dhe probleme me sistemin e ngrohjes. Kushtet e brendshme kanë nevojë për përmirësim.

Z. Riza Uruci, banor fshati Golem shprehet se ka shumë probleme të akumuluar ndër vite:

- Problem kryesor është rruga për të cilën ka projekt por akoma nuk është filluar me investimin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

- Nuk ka ujësjellës në fshat. Tubacioni i dikurshëm nuk funksionon dhe është e vështirë të kemi edhe uji nga pusët.
- Kurse përse i përket mbetjeve duhet që Bashkia të filloi me gjoba tashme për banorët.
- Edhe dalja e rrugës së Golemit në kryqzim me shinat e trenit duhet të bëhet e rregullt dhe të mos ketë tabelë për kundravatje, sepse na ndihmon shumë.

Një tjetër problem është për banorët është edhe energjia elektrike dhe kërkojmë nga Bashkia të na ndihmojnë për zgjidhjen e kësaj situatë provizore prej tre vite tashmë.

Z. Kristian Vukaj, banor fshati Hot i Ri merr fjalën dhe shpreh një shqetësim personal në lidhje me prishjen e një avullie, e cila i është prishur pa të drejtë sipas tij. Prandaj ai pret një sqarim nga ana e Bashkisë sepse prona është e pajisur me dokumentacion të rregullt.

Z. Bajram Nikaj, banor fshati Golem shprehet se problem vazhdon të jetë:

- Rrjeti i ujësjellësit.
- Rruga mes varrezave në Golem nuk ka kanale dhe uji që vjen nga varrezat na futet në shtëpia e oborre.

Z. Ded Narkaj, banor ndan të njëjtën problematikë dhe tjetër shqetësim i tij është një tarifë , që i ka ardhur për pagesë nga Bashkia lidhur me legalizimet, ku mendohet që legalizimi të jetë falas.

Z. Mark Kotaj, banor pranë vinotekës shprehet se:

- Rruga e Vinotekës është problematike përse i përket ndriçimit.
- Komuna Rrethina nuk sot ujë të pijshëm dhe ka nevojë për përmirësimin të infrastrukturës.
- Zona ka nevojë edhe për transport urban.

Znj. Mirela Mataj, banore shprehet se varrezat e fshatit Shtoj i ri kanë nevojë për rikonstruksion dhe për një sistemim të gjithë zonës.

- Rruga nga fermentimi deri në urën e mesit akoma nuk është marrë në dorëzim ka problem edhe me ndricimin, i cili nuk dhe është akoma funksional.
- Rruga e vorrezave ka nevojë për nderhyrje.
- Qendra shëndetësore Hot i Ri nevojë urgjente për nderhyrje në infrastrukturë.

Z. Dritan Alija, kryeplak i fshatit Dobraq përsërit problematikën e ujit të pijshëm. Ai thotë se mungesa e ujit është shqetësim i vazhdueshëm për rreth 6000 mijë banorë. Të njëjtin shqetësim kanë edhe banorët e Golemit. Po ashtu ai shton se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

- Kemi problem me pastrimin dhe mbeturinat. Në Dobraç banorët i djegin, pasi makina vjen një herë në dy ditë dhe kjo nuk mjafton sepse ka shume popullsi dhe vetem tre pika grumbullimi. Duhet shtuar kazanat, pikat e grumbullimit dhe duhet rritur frekuenca.
- Tek rruga e pompave është bërë ndërhyrje nga ujësjellësi por nuk është rregulluar akoma. Ka më shumë se një muaj e gjysëm dhe askush nuk merr masa për këtë.
- Kemi problem edhe kanalet e kullimit në të cilat nuk është ndërhyrë me vite. Janë të mbyllura krejtësisht. Në rast ëermbytjeje rrezikojmë shumë.

Kryetari i bashkisë, Z.Beci përgjigjet në lidhje me mbeturinat duke thënë se sistemi është përmiresuar dhe qyteti nuk e ka më këtë problematikë, tashmë jemi të fokusuar tek njësitë administrative. Kjo është fokusi jonë kryesor. Do të shohim situatën në zonën në fjalë që të shtojmë pikat dhe frekuencen.

Z. Dritan Shameti kërkon që pikat e grumbullimit të mos caktohen afër shkollave.

Z. Lek Pepniku, banor fshati Shalë shprehet se kanë problem me energjinë elektrike. Problem ky që s'ka gjetur zgjidhje asnjëherë. Bëhet fjalë për rreth 15 banesa, të cilat janë të gatshme të bëjnë edhe kontrata.

Z. Brahim Isufi, banor fshati Bardhaj thotë se shqetësim për to është rruga poshtë urës që lidh njësinë Rrethina dhe fshatin Bardhaj, Rruga SELIMAJ.

Z. Hilmi Kurtaj, banor shprehet se zona e Rrethinave ka nevojë edhe për :

- librari dhe ambjente kulturore
- ndërhyrje në rrugën e Golemit
- Ujë të pijshëm
- Ndërhyrje në infrastrukturën e shkollës së Golemit.

Besmir Selimi, banor fshati Bardhaj po ashtu kërkon shtrimin e rrugës për banorët pranë bregut të lumit Kir. Bëhet fjalë për 500 – 600 metër .

Kryetari i bashkisë, Z.Beci shprehet se ndërhyrjet do realizohen sipas prioriteteve dhe nevojave .cdo gjë është mbajtur shënimm dhe do të bëhet një listë me investimet që do ndërmerren. Kurse problemin e ujit jemi duke e zgjidhur me donatore si KFË.

Z. Ramiz Zeka, banor fshati golem ndan po të njëjtat shqetësime për ujin dhe për kanalizimet në zonë. Po ashtu ai shton se :

- Puset nuk funksionojnë sepse kemi edhe gropa septike të cilat i nxjerrin jashtë përdorimi puset.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

- Kemi nevojë për një shkollë profesionale për komunën Rrethina. Disponojmë pronësi të tokës shtetërore dhe jemi njësi më e madhe me mbi 26000 banorë.
- Ka nevojë për ndërrhyrje në rrugën Hysaj, rrugën e vorfjanëve dhe rrugën që ndan fshatin Shtoj i ri dhe Golem.
- Energjia elektrike ka shumë shpesh probleme nga rrjeti i shpërndarjes së energjisë.

Tjetër banor i fshatit Hot i ri shprehet se kanë probleme me:

- Ujësjellës, i cili ka filluar por është i papërfunduar.
- Nuk ka kanale vaditëse, ekzistueset janë të bllokuara.
- Tjetër problema janë invalidët dhe banorët që kanë nevojë për transport publik.
- Duhet rishikuar faturat e energjisë elektrike para 2013.

Znj. Rezarta Pode, Këshilltare K.B merr fjalën dhe liston disa nga shqetësimet e banorëve të kësaj Njësie Administrative të cilat kanë nevojë për vëmendje:

1. Ndriçimi publik jo vetëm në pikat kryesore por edhe brenda fshatrave.
2. Rruga e varrezave.
3. Shtimi i kazanave dhe frekuencës.
4. Pastrimi i rrugëve dytësore
5. Kanalet kulluese në Grudë, Guci, Shtoj i ri dhe Shtoj i vjetër.
6. Shtrimi i rrugëve dytësore.
7. Ndalimi i hedhjes së inerteve tek fusha e aviacionit.
8. Ujësjellësi .
9. Riparimi i qendrave shëndetësore në Golem dhe në të tjera fshatra.
10. Shtimi i aktiviteteve kulturore për zonën.
11. Një qendër komunitare për zhvillimin e aktiviteteve socio-kulturore dhe sportive në zonë.
12. Shtimi i pikave të tregtimit që do ndihmojë tregtimin e produktit lokal.

Banorë, fshati Dobrac i ri, rruga e pompave shprehet se tjetër problem për të është:

- Pastrimi në bypass nuk kryhet dhe ka as mirëmbajtje të kësaj rruge në lidhje me prerjen e shkurreve.
- Me mbeturinat nuk shihet përmirësim, ka nevojë për shtim frekuence.
- Pas ndërrhyrjeve nga ujësjellësi duhen riparuar edhe dëmet.
- Mungesa e legalizimeve bën që të kemi edhe investime të ulta.
- Duhet ndërrhyrje tek kanalizimet e bllokuara nga ndërtimet e bëra.

Z. Fatbardh Dama, Këshilltar i K.B shprehet se investimi i bërë para pak kohësh tek rruga e pompave nga Bashkia ka krijuar problem për ujrat e bardha. Kemi nevojë të ndërrhyhet me fadromë për të liruar kanalin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Banore, fshati Hot i Ri shprehet lidhur me:

- kanalin vaditës në Hot të ri, i cili duhet rihapur.
- Fusha e Shtojt nuk duhet të shërbejë për varreza por të jetë tokë bujqesore.

Z.Agron Sadiku, kryeplaku Shtoj i Ri merr fjalën dhe shpreh shqetësimet e banorëve lidhur me:

1. Rihapjen e hyrjes së fshatit Shtoj.
2. Hapje kanali ujrash të bardha sepse uji kthehet në oborret e banesave.
3. Rrjetin elektrik nga OSHEE.
4. Tre rrugica që kanë nevojë për ndriçim për të rritur edhe sigurinë gjatë natës.
5. Varrezat kanë nevojë për një rrethim.
6. Pastrimin, i cili është bërë por ka problem me mbeturinave nga pastrimi i oborreve dhe bahqeve.

Z.Oltion Luli, Kryetar i Këshillit bashkiak sqaron se Këshilli ka miratuar një rregullore përse i përket sistemimit të kesaj problematike.

Z.Shpresim Duli, banor shpreh shqetësimin e tij lidhur me pajisjen me tapi për shtëpitë e tyre.

Z. Zija Cinari, banor fshati Golem po ashtu shprehet se:

- Ka mungesë ndriçimi e gjithë zona nga Dobraçi deri në qendër Golem.
- Ka probleme me ujsjellësin.
- Ka nevojë për vëmendje edhe për rrjetin rrugor në Golem.

Z.Angjelin Prendi, banor i fshatit Hot i ri shprehet gjithashtu se:

1. Rrjeti i ujësjellësit është i papërfunduar dhe është problem për banorët e Hotit të ri, Gucisë, tek Vinoteka dhe për një pjesë të Golemit.
2. Ka nevojë emergjente për pastrimin e kanaleve vaditëse, nuk është vënë dorë prej 23 vitesh.
3. Duhet parë mundësia e linjës së urbanit për Bahcallek-Ura mesit sepse me operatorët privat është shumë e kushtueshme brenda njësite.
4. Mundësisht të ketë amnisti për faturat e energjisë të viteve të mëpaërshme.

Z.Oltion Luli, Kryetar i Këshillit bashkiak mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Velipojë.

Data : 11.10.2023

Ora :13:00

Vendi: Pranë

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 25, nga të cilat 4 gra, dhe 21 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Loc Ftoni** – kryeplak i fshatit Rrjoll i cili shpreh shqetësimet e tij dhe të banorëve të zonës:

1. Shkolla e fshatit nuk është më funksionale pasi nuk ka nxënës. Gjendja e saj infrastrukturore është e mirë por nuk frekuentohet për arsye se nxënësit shkojnë në shkollat e qytetit ose në shkollën më të afërt, atë të Velipojës, rreth 8 km larg.
2. Furnizimi me ujë është tjetër problematikë. Zona nuk ka ujë as në periudhën e verës, sezonit turistik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Rruga e Vilunit është po ashtu problem pasi asnjë nga rrugët për dalje në plazh nuk është e sistemuar. Duhet parë me prioritet sepse ka biznese dhe turista që frekutojnë zonën.
4. Ndriçimi po ashtu mungon në të gjithë zonën.
5. Shërbimet për gjelberim pastrimin gjithashtu mungojnë sidomos në plazhin publik.
6. Qendra shëndetësore i ka kushtet por kemi nevojë për një infermier që kryen shërbime me grafik në këtë zonë sepse Rrjollit me Velipojën kanë distancë të madhe.
7. Edhe varrezat e zonës se Rrjollit kanë nevojë për rrethim dhe sistemim.

Kryetari i këshillit **Z.Oltion Luli** përgjigjet se përsa i përket shkollës së fshatit do kemi mundësinë ta diskutojmë me ZVA për te koordinuar për këtë problematikë.

Z. Demush Malecaj, banor fshati Luarez shprehet se:

1. Rrugët e lagjeve në fshatin Luarez kanë nevojë për rishikim e ndërhyrje pasi janë tre lagje që lidhen përmes tyre. Po ashtu lidhjet e fshatrave nga Luarez në Ças janë rreth 400 – 500 metra rrugë.
2. Kanalet kulluese po ashtu janë problem. Faktikisht nuk është pjesë e Bashkisë por kemi nevojë për mbështetje dhe ndërhyrje pranë Bordit të kullimit
3. Edhe për varrezat e zonës ka kërkesë të madhe nga komuniteti për rrethim dhe sistemim

Kryetari i fshatit Ças merr fjalën dhe kërkon tre ndërhyrje që janë shumë të rëndësishme banorët:

1. Investim në kanalin kullues 2, 3 dhe 11. Janë rreth 300 hektar tokë që kullohen përmes këtyre kanaleve.
2. Është bërë investim i rrugës së fshatit por ka mbetur edhe asfaltimi brenda pallateve, janë rreth 200 – 300 metra.
3. Po ashtu është investuar për ujrave e zeza, janë bërë derdhjet por duhet që të hapen kanalet që lidhin këto kanalizime me shkarkimet.

Zv/ kryetari i bashkisë **Z. Rudin Beka** kërkon që për këtë të përgjigjet **Z.Alban Sekja**, drejtor pranë drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkodër duke e njohur konkretisht situatën. **Z.Sekja** sqaron se është bërë kërkesë tek Bordi i kullimit për të ndërhyrë në këtë zonë, si në fshatin Ças ashtu edhe në Luarez.

Z.Arjan Perndrecaj, banor fshati Gomsiqe shpreh shqetësimet e tij:

1. Problemi kryesor është uji sepse furnizohemi vetëm një orë ujë në ditë.
2. Tjetër problem është legalizimi i pronave, jemi banorë që prej vitit 1971 dhe na thuhet se projektet e Bashkisë përbëjnë problem për këtë. A mund të kemi një sqarim rreth kësaj situatë që të marrim pronat tona.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Përgjigjet Zv/Kryetari i bashkisë **Z.Onid Bejleri**, i cili shprehet se për tokat është krijuar një komision për rregjistrimin e tokave me ligjin 7501. Kurse përsa i përket legalizimit të shtëpive në lidhje me projektet që do të bëhen është një problematikë në zgjidhje në bashkëpunim me hipotekën.

Z.Perndrecaj shprehet se ne i mirëpresim këto investime dhe jemi të gatshëm të njihemi sipas afateve për këto ndërhyrje por duam që të kemi edhe pronësitë tona. Edhe për prishjet e barakave apo të një muri avullie nuk ka pse të ndërhyjë Policia dhe IMT sepse mendoj që nuk duhen të vendosen gjoba dhe penalizohen njerëzit për këto gjëra të vogla.

Zv. Kryetari **Z.Bejleri** shprehet se ne kërkojmë gjithmonë mirëkuptimin e banorëve në rastet kur prishet një gardh apo një mur kur kemi investime rrugësh. Çdo projekt që hartohet është në formën që të bëjë sa më pak dëme në pronë.

Z.Besnik Ndoj, përfaqësues për sportin në Velipojë dhe për ndërtimet merr fjalën dhe shprehet se përsa i përket sportit nuk është cekur ndonjëherë nevoja për këtë sektor. Investoj që 12 vite tek ADA, akademia e futbollit dhe vetëm falë ndihmës së famulltarisë është bërë e mundur fusha sportive. Mirëmbajtjen e fushës e bëjmë me fondet tona dhe kërkojmë mbështetje. Duhet të stërviten minimalisht 300 – 500 fëmijë, të cilët merren me sport dhe i largohen rrugëve dhe veseve. Velipoja ka patur 7 fusha sporti kurse sot është vetëm një që është pronë e famullisë dhe aty nuk pranohen investime. Ne kemi nevojë për fusha të tjera sportive që mund të bëhen në toka publike. Sot nuk kemi as fonde dhe është e vështirë të vazhdojmë pa patur mbështetje nga ana e Bashkisë.

Zv/Kryetar **Z.Rudin Beka** pyet nëse ka ndonjë sugjerim për tokë publike, që mund të ndërhyhet tek federata për të pasur një investim ?

Z.Besnik Ndoj shprehet se duhet të bëhen verifikime nga Bashkia. Ne jemi të gatshëm për bashkëpunime për çuar përpara projekte për fusha sportive në Velipojë.

Kurse në lidhje me ndërtimet shprehet se ndërtimet i kemi të bllokuara komplet që 4 vite dhe kjo pengon edhe rrogat dhe familjet të kenë një punë stabil. Po ashtu:

1. Velipoja ka 10 mijë banorë, përbëhet nga 12 fshatra, zonë turistike dhe prej 32 vitesh nuk ka një park lojrash për fëmijë, për banorët dhe turistët. Është investim shumë i rëndësishëm që duhet bërë.
2. Energjia elektrike është tjetër problem për banorët. Duhet ndërhyrë pranë OSHEE për rrjetin e furnizimit me energji pasi në mot të keq ndërprehet furnizimi.
3. Furnizimi me ujë, kemi vetëm dy orë në ditë dhe shpesh ujë që nuk pihet.
4. Rrugët janë shtruar por ka nevojë për më tepër.
5. Ka nevojë për ndriçues brenda lagjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Do ishte shumë mirë që të ngrihej një grup pune i posaçëm që të kryejë verifikime për Velipojën duke ditur edhe rëndësinë e zonës që kontribuon kaq shumë në zhvillimin ekonomik të të gjithë Shkodrës.

Z.Pashko Brryli , banor Velipojë merr fjalën dhe shpreh shqetësimet e tij:

1. Kemi nevojë të shihet dhe të ndërhyhet në parkinkun e shkollës Velipojë, pasi është dalje e rrezikshme për fëmijët. Kemi një vendparking por është bllokuar nga i zoti i tokës
2. Ka filluar procesi ivendosjes së ndriçimit por aty ka shumë shtylla të vendosura nga kompanitë e celulareve dhe sugjeroj të futet edhe linja e internetit në këto tuba.
3. Po ashtu do ishte mirë që me ndriçimin njëkohësisht të të bëhet edhe gjelberimi i karregjatës rreth shtyllave.
4. Janë vendosur shtyllat por mungojnë shtyllat prane kishës , ku ka edhe parkim dhe duhet të shtohen deri tek kisha.
5. Kryetari i Njësisë ka ndërhyrë për sa i perket gjuetisë së paligjshme në Velipojë i cili është totalisht e palicencuar. Kërkojmë ndërhyrjen nga Policia e Shtetit për ndalimin e gjuajtjes së peshkut me dinamit , gjë që na dëmton të gjithëve.
6. Edhe kanalet kanë nevoja të shumta por edhe ne si banorë duhet të jemi të përgjegjshëm që t'i lirojmë nga avullit.
7. Që me aprovimin e 7501 nuk kemi marrë akoma tapitë, kërkojmë të ndërhyhet nga Bashkia për këtë situatë.

Z.Altin Salihi, specialist pranë drejtorisë së Shërbimeve publike në Bashkinë Shkodër sqaron se fondi për ndriçimin ka qenë i limituar, por projekti do të vijojë deri në pjesën e kishës dhe me tej. Sa i përket futjes së telave të tjerë do kryhen sapo të behen trotualet.

Z.Ndrek Gjoni, banor fshati Gomsiqe thotë se administratori i zonës ashtu si ato më përpara, kanë vite që kalojnë pranë një kanali ujrash të bardha këtu afër njësisë ku shkarkohen të gjitha ujrat e zeza. Pikerisht pranë njësisë administrative sipër. Kanalet e papastruara nga mbeturinat, është konkretisht tubi 120 D, që shkarkohet në këto kanalizime të ujrave të bardha. Të gjithë paguajmë para për të pastruar gropat septike, prandaj duhet gjetur një zgjidhje.

Zv/Kryetari **Z.Onid Bejleri** sqaron se administratori së bashku me ujësjellësin do të vijë në zonë, që të jetë në dispozicion për këto pastrime, por edhe për problemin e e ujit të pijshëm.

Z.Gac Prroni , banor i fshatit Reç i Ri shprehet se kanë problem me:

1. Sistemimin e ujërave të zeza.
2. Nuk ka as gjelbërim, asgjë ndërkohë që paguajmë të gjitha taksat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

3. Edhe rruga që është bërë nuk është përfunduar dhe është thjesht investim elektoral, nuk ka as drita asgjë. Një kanal që është vendosur për ujin ka të përziera edhe ujërat e zeza .
4. Për ndërhyrje të vogla në shtëpitë tona kërkojmë të mos penalizohemi.
5. Njohja e pronave, kemi nevojë të ndërhyhet për të marrë dokumentacionin përfundimtar.

Zv/Kryetari **Onid Bejleri** përgjigjet se për një pjesë punimesh nuk ka nevojë për leje dhe për këtë duhet të sqaroheni me administratorin. Leja është e domosdoshme vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me ndryshime në strukturën e banesës.

Administratori shton se ka patur dy raste që janë proceduar për riparime çatie.

Përsëri Zv/Kryetari Z.Bejleri sqaron se ka raste që është marr leje për riparim çatie dhe pastaj është shtuar një kat shtëpie. Prandaj nuk duhet abuzuar me këtë pikë. Kryetari i fshatit dhe administratori duhet të jenë të përgjegjshëm dhe të dinë ku ndërhyhet dhe çfarë dokumentacioni duhet të ketë.

Z.Emir Sadiku, banor fshati Luarez shprehet se:

1. Lidhja e rrugëve të tre lagjeve duhet parë, po ashtu mund të vendosen edhe ndriçues sepse i paguajmë të gjitha detyrimet.
2. Qendra shëndetësore është ndërtuar vite më parë por nuk ofrohet shërbim me infermier. Mendoj se duhet të komunikohet me DSHP për të sjellë personel mjekësor.
3. Për rrugët kërkojmë ndërhyrje pasi janë distanca shume të shkurtra dhe nuk kërkohet investim shumë i madh.
4. Shqetësim i madh është kanali i Luarzit sepse është pothuajse gjithmonë i bllokuar.

Banor fshati Mali Kolaj merr fjalën dhe thotë:

1. Ujësjellës në zonë nuk funksion, nuk furnizohemi me ujë prej shumë vitesh.
2. Rrugët e zonës në Mali Kolaj që lidhin fshatin me rrugën kryesore dhe nuk kanë ndriçim.
3. Edhe tubacioni i ujit ka nevojë për verifikim.
4. Kemi edhe probleme me shkollën e fshatit sepse ka probleme me pronësinë. Duhet parë mundësia e ndërtimit të një shkolle, marrje me qira e një hapësire për këtë sepse ka nxënës që e frekuentojnë dhe nuk duam që kjo shkollë të mbyllet.

Administratori shprehet se ka shumë burokraci tek pjesa e ujësjellësit dhe duhet nderhyë patjetër.

Zv/Kryetar **Z.Bejleri** sqaron se problemi i shkollës është shumë specifik sepse Bashkia nuk mund të marrë me qera një pronë që ndoshta figuron në Lezhë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Për këtë pjesë po merret Kryetari i bashkisë personalisht sepse ka shumë probleme me pronësitë si pasojë e gabimeve në ndarjen territoriale.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka Kryetari i këshillit falenderon për diskutimet dhe thotë se njësia administrative e Velipojës ka përfaqësuesit e saj në Këshillin bashkiak përmes të cilëve mund të adresohet çdo problematikë. Ai shton gjithashtu se në lidhje me shërbimet publike në këtë zonë është bërë një punë e vazhdueshme nga ana e Bashkisë por duhet edhe ndërgjegjësimi i banorëve sidomos për mbetjet organike që nuk duhet të hidhen në koshat e plazheve sepse krijojnë shumë probleme në menaxhim. Kemi miratuar planin dhe rregulloren e shërbimeve publike dhe kerkoj nga ana e juaj që të jeni të përgjegjshëm ndaj kësaj çështjeje.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2023

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : Njësia administrative Gur i Zi.

Data : 17.10.2023

Ora : 13:00

Vendi: Qendra Komunitare

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 36, nga të cilat 4 gra, dhe 32 burra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Z.Samir Guri, banor fshati Vukatanë merr fjalën dhe shprehet se:

1. Janë disa rrugë të lagjeve të cilat janë të papërfunduara që lidhin lagjet e banoreve janë rreth 2.5 km rrugë.
2. Kanalet kulluese dhe vaditëse ,një tjetër ndërhyrje e kërkuar.
3. Shkolla Juban duhet të bëhet me një kënd sportiv.
4. Duhet të vendoset sinjalistikë pranë shkollës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Përgjigjet **Z.Alban Sekja** drejtor i drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkodër se për sa I përket kanaleve kulluese dhe vaditese kemi një projekt që do të fillojë zbatimin shumë shpejt dhe për këtë do kemi edhe përkrahjen e qeverisë. Infrastruktura e ujitjes ka nevoja të medha sepse edhe shtrirja e këtyre kanaleve është shumë e gjërë.

Kryetari i njësisë sugjeron që të ketë një punonjës për të bërë verifikime për kanalet, posaçërisht për këtë sektor. Është filluar faza e parë në kanalin e Gajtanit dhe në Gur të zi për sistemimin e shembjeve dhe dëmtimeve dhe është e nevojshme që të kemi pagesa nga njësitë administrative dhe përdoruesit pikërisht për të patur mundësi të bëjmë ndërhyrje nga bashkia. Tarifa e ujitjes është vetëm për ato që janë përdorues.

Z.Bahri Osmani, banor fshati Vukatanë shprehet se në kanalin vaditës në Vukatanë nuk është ndërhyrë që prej 30 vitesh dhe ka nevojë emergjente. Pjesa tjetër e kanaleve kulluese është bërë por mbetur pjesa tjetër akoma pa filluar.

Përgjigjet Kryetari njësisë duke thënë se puna ka filluar dhe së shpejti do të shihni rezultatet.

Z. Angjelin Haxhari, banor fshati Rragam thotë se:

1. Ura në lagjen Danaj që lidh tre fshatra është problem.
2. Po ashtu edhe rruga e Gjocit ka nevojë për ndërhyrje.
3. Gjithashtu duhet shtuar ndricimi në zonën e Rragamit.

Z.Alban Sekja përgjigjet përsëri që janë 4 ura të parashikuara për tu ndërhyrë.

Tjetër banor i fshatit Juban kërkon që të bëhet rikonstruksion i shkollës së Jubanit.

Z.Gjelosh Bicaj, banor i fshatit Rragam shprehet se në zonën e Gurit të Zi vetë banorët kanë filluar të bëjmë disa ndërhyrje vete por është e nevojshme të punohet shumë edhe nga Bashkia. Gjithashtu duhet ndërhyrë edhe në rrugën që lidh dy karburantet deri në qëndër Rragam dhe tek rruga e Pistalles. Emergjente është ndërtimi i një ure por e vjetra nuk duhet prishur pa përfunduar e reja sepse bllokohet e gjithë zona. Turizmi në këtë zonë por kryesisht banorët kanë nevojë të madhe për rikonstruksionin e kësaj ure. Edhe ndriçimi është shumë i rëndësishëm. Po ashtu pastrimi i ishullit të Shurdhahut. Kemi shumë nevojë për përmirësim të shërbimeve të pastrimit. Duhet bërë edhe verifikimi i nevojave për asfaltim të rrugëve.

Fjalën e merr Zv/kryetari **Z.Onid Bejleri** i cili thotë që projekti ekzistues për urën në Rragam nuk do të realizohet pasi jemi në fazën ku nga Min. e Mbrojtjes po marrim një buxhet për të bërë disa ura, ndër të cilat është edhe kjo urë.

Përsa i përket infrastrukturës së rrugëve , në këtë moment po asfaltohet në zonën e Kuqit, në lagjen Grenas etj. Është vetëm fillimi i një pakete investimesh nga FSHZH që do të prek një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

sërë rrugësh. Nevojat do të na vijnë përmes administratorit dhe ndërhyrjet do kryhet sipas prioriteteve më të mëdha dhe në numër popullsie.

Banor, fshatit Rragam shprehet se:

- Nëse është e mundur të ndërhyhet në pastrimin e karregjatës së rrugës së Rragamit.
- Të bëhet edhe zgjerimi i rrugës.
- Duhet bërë asfaltimi i lagjeve brenda Rragamit.
- Shtimi i ndricimit është i nevojshëm.
- Për vaditjen nuk ka sistem shtetëror të vaditjes.
- Për energjinë elektrike të ndërhyhet me OSHEE për rrjetin elektrik.
- Zona e Pistalles ka problem përmblyetje, ka nevojë për pastrim prroni i Pistalles
- Shkollës i duhet një kënd sportive.
- Dhe duhet të hapen tualetet e shkollës Rragam.
- Duhet shtim i koshave të mbeturinave.

Z.Merita Quku, drejtore Shkolla fshati Kuq thotë se:

1. Kemi përmblyetje në shkollë prandaj duhet sistemuar oborri i shkollës sepse i gjithë uji mbulon oborrin.
2. Të ndahet qendra sanitare me shkollën ose të ketë hyrje në vehte.
3. I gjithë kati I i shkollës ka përmblyetje dhe duhet ndërhyrë.
4. Kemi nevojë për bazë materiale për shkollën e Kuqit, pasi ka rreth 40 nxënës dhe nëse ka kushte të mira banorët do i lënë fëmijët në këtë shkollë.

Z.Gëzim Lahi, banor fshati i Gurit të Zi shprehet se

1. Rruga e varrezave muslimane lidh Jubanin me Gurin e Zi dhe ka nevojë për shtrim asfalti rreth 2.5 km.
2. Po ashtu edhe rruga e varrezave katolike ka nevojë për asfaltim (800 metra).
3. Edhe rrugët e lagjeve të brendshme të fshatit Guri i zi kanë nevojë për ndërhyrje.
4. Gjithashtu në Gur të zi mungon ndriçimi.
5. Të shtohen koshat e mbeturinave dhe frekuenca.
6. Në lidhje me ujësjellësin, e paguajmë të gjithë tarifen dhe nuk marrim shërbim.
7. Tek ura në qendër të Gurit të zi kur ka rreshje uji shkarkon në fshat dhe duhet ndërhyrje tek ura dhe të bëhen kanalet e ujrave të bardha .

Kryetari i këshillit bashkiak **Z.Luli** shprehet se një pjesë e llampave që do dalin të tepërta në Shkodër nga projekti i vendosjes së ndriçuesve LED do të transferohen në njeëiteë administrative. Sa i perket mbetjeve urbane kemi në Këshill bashkiak dy rregullore për mbetjet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

urbane dhe kundravajtjet administrative që duhen respektuar nga banorët për të marrë edhe shërbimin e pretenduar.

Z.Ferdinand Jaku, banor i Jubanit thotë se:

1. Shkolla e Jubanit ka shumë problematika të cilat duhen verifikuar në terren, duke filluar që nga tualetet e deri tek infrastruktura pasi nuk ka pasur asnjë investim.
2. Rruga nacionale ka nevojë për sinjalistikë dhe vendosje trotuari sepse është shumë e rrezikshme.
3. Ndriçimi në zonë gjithashtu duhet të shtohet.
4. Ujësjellësi po ashtu është problematik e trashëguar.
5. Edhe rrjeti i energjisë nuk ka gjetur zgjidhje.
6. Në zonën e Jubanit nuk është investuar në vite dhe duhet të verifikohen nevojat e mëdha që ka zona.

Ne lidhje me trotuarin ërgjigjen zv/kryetari i bashkisë **Z.Onid Bejleri**, i cili thotë se kemi patur probleme pronësie për ta realizuar trotuarin në rrugën nacionale po ashtu edhe për ndriçimin duhet të kemi dakordësinë e banorëve.

Banor në zonën e Rencit, përfaqësues i bizneseve të zonës shprehet se :

1. Kanali kryesor pranë ish uzinës së telit dhe prroni pranë uzinës krijon probleme shumë të mëdha në rast përmbytjesh. Aty jemi 7 biznese të mëdha dhe çdo vit përmbytemi duke na bërë dëme të mëdha ekonomike.
2. Kemi gjithashtu nevojë për asfaltimin e rrugës pranë bizneseve tona.

Z.Arian Gjura, banor i fshatit Juban thotë se dendësia e popullsisë në zonë është shumë e madhe dhe normalisht duhet të jetë në prioritetet e bashkisë. Ai shton se :

1. rruga që lidh Jubanin me Vukatanën dhe Shkodrën ka një fluks shumë të madh makinash tashmë edhe nga turizmi dhe ka nevojë për pastrim por edhe zgjerim dhe riasfaltim te saj.
2. pastrimi i kanaleve në këtë rrugë është me shumë rëndësi gjithashtu.
3. Në lidhje me energjinë elektrike Bashkia duhet të komunikojë me OSHEE për të rikualifikuar rrjetin elektrik.
4. rrugët brenda fshatit Juban duhen shtruar.
5. ka nevojë për trotuar gjithashtu në zonë.
6. rrjeti i rrugëve që do bëhen, duhet të jetë me kanalizimet e nevojshme.
7. Edhe komuniteti mund perfshihet kur në bashkëfinancim në shtrimit e rrugëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Znj.Rezarta Pode, anëtare e Këshillit bashkiak shprehet se janë me shumë rëndësi rrugët në fshatin Rrenc.

Po ashtu ka një kanal vaditës që kalon nga Guri i Zi sipër fshatit i cili shkon deri në Juban dhe ka nevojë për pastrim. Edhe shkolla e Jubanit duhet të verifikohet nga Dr. e Arsimit për nevojat që ka. Emergjente janë edhe rrugët e brendshme të Jubanit.

Banor i fshatit Guri i Zi sugjeron vendosjen e një linje urbane Shkodër- Gur i zi. Po ashtu të shihet mundësia e ndërtimit të një trotuari në krah të rrugës.

Z.Metaliaj banor i fshatit Kuq thotë sërish se:

- 1 Hapja e kanaleve të tjera është prioritet sepse rrezikojmë përmbytjen.
- 2 Duhet pastrim i kanalit nga stallat Kuq deri në hekurudhë.
- 3 Duhet verifikuar argjinatura në zonën e Kuqit.

Z.Pjeter Marku, kryeplak i fshatit Sheldi shprehet se:

1. Kemi në zonën tonë 4-5 familje që kanë nevojë për ushqime prandaj duhet parë mundësia e ndihmës nga Shërbimi social.
2. Po ashtu duhet verifikuar kanali kullues në Sheldi.

Z.Leonat Matishi, banor fshati Rrenc thotë se nuk ka pasur asnjë investim nga ana e Bashkisë përveç 1 km linear ndriçim përgjatë rrugës. Ai shton se:

1. rruga e brendshme e Rrencit që lidet me rrugën kryesore ka nevojë për asfaltim
2. po ashtu edhe rruga që lidh komunën Rrethina, Bardhajt me Rrencin.
3. gjithashtu për lejet e ndërtimit për banesat tona duhet të shikohet procedura sepse po ndërtojmë në pronat tona.
4. ka nevojë për rikualifikimin e një sheshi apo hapësire për banorët e zonës.
5. shkolla Rrenc ka 23 pa u lyer, s'ka asnjë shërbim mbështetës. Drejtoria e arsimit të verifikojë mundësinë për të ndërhyrë. Nuk ka as detergjente, as materiale shtesë për shkollën .
6. kemi një ambjent, t palestër në shkollën e Rrencit i cili është funksional por duhet të shikohen mundësitë për mbështetje për mirëmbajtjen e saj.
7. po ashtu ne jemi të gatshëm për të paguar Bashkinë për vaditjen por nuk kemi kanal vaditjeje. Duhet investuar për vendosjen në funksion të një kanali të tillë dhe jemi të gatshëm të paguajmë tarifën përkatëse.
8. Edhe kazanat e mbeturinave kanë nevojë të pastrohen më shpesh pra duhet rregulluar frekuenca. Duhet shtuar kontenierët dhe të largohen nga shkolla pasi krijojnë ndotje të mëdha.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka kryetari i keshillit bashkiak falenderon të pranishmit dhe deklaron të mbyllur takimin.

SEKRETAR

Denis LEZHA

Zbardhi process verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti